



Vlerësimi Institucional i Institucioneve të Arsimit të Lartë në Shqipëri

**Raporti i Universitetit të Shkodrës,
“Luigj Gurakuqi”
Maj 2017**

GRUPI I VLERËSIMIT TË JASHTËM:

1	Dr Carol Vielba	Kryetare
2	Ms Alison Blackburn	Anëtar
3	Professor Mark Davies	Anëtar
4	Professor Raimonda Duka	Anëtar
5	Associate Professor Eglantina Hysa	Anëtar
6	Professor Chris Maguire	Anëtar r

Alison Blackburn

Carol Vielba

Mark Davies

Raimonda Duka

Eglantina Hysa

Chris Maguire

Datë: 15-16 Maj 2017

Përmbajtja

Përmbajtja	3
Rreth këtij vlerësimi	1
Konteksti i këtij vlerësimi.....	2
Raport i përmbledhur	3
Përmbledhje e gjetjeve	4
Përmbledhje e gjykrimeve për çdo Fushë Vlerësimi	5
Gjykim i përmbledhur	5
Raporti i detajuar	6
Fusha e Vlerësimit 1: Organizimi dhe Menaxhimi i tij	6
Fusha e Vlerësimit 2: Burimet	10
Fusha e Vlerësimit 3: Kurrikula	15
Fusha e Vlerësimit 4: Mësimdhënia, Mësimnxënia, Vlerësimi dhe Kërkimi	19
Fusha e Vlerësimit 5: Studentët dhe Mbështetja e tyre	23

Rreth këtij vlerësimi

Qëllimi i përgjithshëm i Vlerësimit Institucional është të vlerësojë në çfarë shkalle IAL-ja përmbush Standardet Shtetërore Shqiptare të Cilësisë, që kanë hyrë në fuqi në vitin 2011. Vlerësimi i jashtëm institucional është procesi i vlerësimit me ekspertë të jashtëm, ku çdo grup ekspertësh përbëhet nga ekspertë të Mbretërisë së Bashkuar, të caktuar nga QAA-ja, dhe nga ekspertë shqiptarë, të caktuar nga Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë (APAAL). Grupi i Vlerësimit të Jashtëm drejtohet nga një ekspert i QAA-së.

Raportet përfundimtare do të shërbejnë jo vetëm për akreditimin institucional, bazuar në shkallën e përmbushjes së standardeve nga IAL-ja, por edhe për të informuar IAL-të, qeverinë shqiptare, publikun dhe studentët se si IAL-ja i përmbush standardet. Ky raport, i ndihmon gjithashtu IAL-të të identifikojnë prioritetet për përmirësime (procesi që ofruesit e arsimit të lartë zbatojnë për përmirësimin sistematik të cilësisë së shërbimit dhe mënyrave për mbështetjen e të nxënit të studentëve). Standardet Shtetërore Shqiptare të Cilësisë janë grupuar në pesë Fusha Vlerësimi: Organizimi dhe Menaxhimi i tij; Burimet; Kurrikula; Mësimdhënia, Mësimnxënia, Vlerësimi dhe Kërkimi; si dhe Studentët dhe Mbështetja e tyre. Ky raport identifikon karakteristikat e praktikave më të mira, rekomandimet, pohimet e veprimeve në zhvillim e sipër dhe dobësitë për çdo Fushë Vlerësimi, duke përfshirë gjykimin se në çfarë niveli IAL-ja i përmbush standardet. Format e gjykimit që ekspertët mund të japin janë: standardet janë përmbushur plotësisht; standardet janë përmbushur kryesisht; standardet janë përmbushur pjesërisht; ose standardet nuk janë përmbushur.

Në fund, ekspertët do ta përfundojnë punën e tyre duke i rekomanduar Këshillit të Akreditimit të APAAL-it një gjykim të përmbledhur. Gjykimi i përmbledhur kryhet përmes një skeme me katër shkallë:

- **Standardet Shtetërore të Cilësisë janë përmbushur plotësisht**
- **Standardet Shtetërore të Cilësisë janë përmbushur kryesisht**
- **Standardet Shtetërore të Cilësisë janë përmbushur pjesërisht**
- **Standardet Shtetërore të Cilësisë nuk janë përmbushur.**

Në kuadrin e procesit të përgatitjes së raportit, QAA-ja ka siguruar ekspertë mbështetës për Grupin e Vlerësimit të Jashtëm duke siguruar që grupi t'i mbështesë gjetjet në raport me fakte, si dhe për korrektimin dhe përmbledhjen e raportit të plotë për përmbledhjen që vijon.

Konteksti i këtij vlerësimi

Universiteti i Shkodrës ‘Luigj Gurakuqi’ zë fill me Institutin e Lartë Pedagogjik të Shkodrës, të themeluar në Shqipëri me Vendim të Këshillit të Ministrave në vitin 1957. Ky ishte institucioni i parë publik modern i arsimit të lartë, që u hap në Shqipërinë Veriore. Gjatë 30 viteve të tij të para, Instituti i Lartë Pedagogjik u përqendrua në diplomimin e mësuesve. Fillimisht, instituti ofronte një program dyvjeçar në shkenca natyrore ose humane, dhe ishte institucioni i vetëm në vend, që ofronte kualifikime për mësuesit e shkollës fillore. Më vonë, afati i programeve të tij të studimit u rrit në tre dhe katërvjeçare, dhe mësuesve që përgatiteshin për shkollat fillore iu jepej mundësia të zgjidhnin midis fushave të larmishme.

Në vitin 1991, Instituti, që në atë kohë mori emrin e patriotit dhe dijetarit Luigj Gurakuqi, u ngrit në rangun e universitetit. U hapën disiplina të reja në fushën e drejtësisë, ekonomikut, gjuhëve të huaja, infermierisë dhe mamisë, punës sociale, sporteve dhe komunikimeve. Me zhvillimin e tij, universiteti e zgjeroi ofertën në tre cikle studimi sipas Procesit të Bolonjës dhe ngriti njësi të posaçme kërkimore për studimet e gjuhës shqipe dhe të ujërave të rajonit të Shkodrës. Koleksioni i literaturës shqipe të bibliotekës është unik, ku përfshihen librat e rrallë dhe botimet e para, të cilat aktualisht janë nën proces digjitalizimi.

Universiteti shërben si qendër kërkimore shkencore dhe arsimore në Rajonin Verior të Shqipërisë. Universiteti është i madh. Për këtë vit akademik (2016-2017), janë regjistruar 12.000 studentë, dhe aktualisht janë punësuar 200 persona si personel me kohë të plotë, dhe 300 me kohë të pjesshme. Universiteti ka lidhur memorandum marrëveshjeje me universitete shqiptare dhe të huaja, të cilat ofrojnë mundësi për mobilitet dhe bashkëpunime.

Raport i përmbledhur

Raporti i Vetëvlerësimit (RVV) u përpilua nga ekipi i ngritur nga universiteti, që përfshinte personelin e nivelit të lartë, stafin akademik dhe personelin administrativ, dhe një përfaqësues të studentëve. Projektraporti, përpara se të përfundohej dhe miratohej nga Rektori dhe Zëvendës Rektori, qarkulloi brenda universitetit për përfitim e komenteve, [M2] gjë që universiteti nuk e kishte praktikuar më parë. Në RVV, paraqitej veprimtaria e universitetit, dhe pasqyrohej në mënyrë të hollësishme shkalla e përmbushjes së standardeve të APAAL-it nga ana e universitetit. RVV-ja mbështetej në dokumente, ndërsa përpara dhe gjatë vlerësimit u përforcua me më shumë dokumente të hollësishme. Jo të gjitha dokumentet ishin të disponueshme në anglisht. Në disa raste, dokumenti kishte paqartësi, me shumë gjasa për shkak të përkthimit, dhe jo gjithmonë përqendrohej te standardet. Në përgjithësi, RVV-ja ishte e dobishme për Grupin e Vlerësimit të Jashtëm, në të cilin bazoi edhe vlerësimin.

Vizita e Grupit të Vlerësimit të Jashtëm u krye përgjatë dy ditëve. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm përbëhej nga katër ekspertë të nivelit të lartë për arsimin e lartë nga Mbretëria e Bashkuar dhe nga dy anëtarë me përvojë në arsimin e lartë nga personeli i institucionit shqiptar. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm u mbështet nga Menaxheri i Vlerësimit dhe mbajtësi i shënimeve të siguruar nga APAAL-i, agjencia përgjegjëse për vlerësimet e arsimit të lartë në Shqipëri. Grupit të Vlerësimit të Jashtëm iu vu në dispozicion Raporti i Vetëvlerësimit dhe një dosje me dokumente mbështetëse, tetë javë përpara fillimit të vizitës së vlerësimit, të plotësuara më pas nga dokumentet e kërkuara shtesë. Gjithsej, u morën në konsideratë 150 dokumente, të cilat e ndihmuan grupin e vlerësimit të njihje me strukturën, politikat, procedurat e drejtimit, godinat, si dhe me veprimtarinë e mësimdhënies dhe kërkimore të ndërmarrë nga universiteti. Dokumentet që u shqyrtuan përfshinin Statutin e Universitetit, Rregulloret Akademike, Raportet Vjetore, procedurat e pranimit dhe orientimit, gamën e marrëveshjeve të jashtme, shembujt e informimit rreth programit dhe dokumentet nga mbledhjet vendimmarrëse.

Gjatë dy ditëve të vizitës së vlerësimit, u organizuan një sërë mbledhjesh, që i mundësuan Grupit të Vlerësimit të Jashtëm të kuptojë më qartë përgjegjësitë, procedurat dhe pikëpamjet e personelit dhe studentëve. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm u takua me Rektorin, drejtuesit e nivelit të lartë, stafin akademik, personelin mbështetës dhe administrativ, alumni dhe me përfaqësuesit e organizatave vendore dhe partnere. Gjatë të gjitha takimeve u mbajtën shënime. Si pjesë e turit të universitetit, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm vizitoi bibliotekat, sallat e kompjuterëve, laboratorët, hapësirat e mësimdhënies dhe ambientet administrative. Gjithashtu, ata patën mundësi të shihnin sistemet universitare elektronike të informacionit për personelin dhe studentët. Pas vlerësimit të të gjitha dokumenteve të vëna në dispozicion, grupi arriti në përfundimet e mëposhtme.

Universiteti i përmbush kryesisht standardet për Organizimin dhe Menaxhimin e tij. Organizimi i universitetit përcaktohet në Statut dhe Rregullore, dhe gjatë mbledhjeve zyrtare respektohen procedurat dhe protokollet e miratuara. Universiteti po përparon drejt përmbushjes së kërkesave të Ligjit 80/2015. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm pohoi hapat që po ndërmerren për fuqizimin e këshillimit të jashtëm të pavarur për punën e Njësisë së Brendshme të Sigurimit të Cilësisë (NjSBC) dhe punën e universitetit gjatë zbatimit të strategjisë së zhvillimit.

Universiteti i përmbush pjesërisht standardet për Burimet. Përgjegjësitë për burimet janë përcaktuar qartësisht në Statutin dhe në Rregulloret e Universitetit, të cilat përmbushen në mënyrën e duhur nga Rektori, Senati Akademik dhe Bordi i Administrimit. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm vërtetoi se, në përgjithësi, sistemet dhe proceset e universitetit janë efikase dhe të përshtatshme për menaxhimin e burimeve njerëzore dhe fizike. Megjithatë, grupi identifikoi një dobësi lidhur me përmasat dhe kushtet e ambienteve fizike, të cilat nuk i përmbushnin standardet e kërkuara. Universiteti do të marrë masa për garantimin e përmbushjes së standardeve të kërkuara në lidhje me hapësirën fizike. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë karakteristikë të praktikës së mirë dhe nuk bëri asnjë pohim.

Universiteti i përmbush kryesisht standardet për Kurrikulën në tre ciklet sipas Procesit të Bolonjës. Programet e ofruara pasqyrojnë misionin e universitetit dhe rolin e tij në rajon dhe në tregun e punës. Programet e studimit janë të përcaktuara qartë dhe studentëve iu jepet informacioni i duhur brenda afateve kohore. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm pohoi veprimet që po ndërmerren për të garantuar

realizimin e 70 përqindëshit të ngarkesës mësimore në studimet e ciklit të parë dhe të dytë nga ana e stafit me kohë të plotë. [**Kapitulli I Standardi I.9**] Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë karakteristikë të praktikës së mirë, nuk identifikoi asnjë dobësi, nuk dha asnjë rekomandim dhe nuk bëri asnjë pohim.

Universiteti i përmbush kryesisht standardet për Mësimdhënien, Mësimnxënien, Vlerësimin dhe Kërkimin. Axhenda e kërkimit shkencor e universitetit është në zhvillim. Mësimdhënia menaxhohet në mënyrë të rregullt. Megjithatë, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm e identifikoi si dobësi mungesën e qasjes efikase mbarë universitare për nxitjen e përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies, si për anëtarët e rinj të personelit, ashtu edhe për ata me përvojë. Rekomandohet që universiteti të vërë në punë një sistem efikas së bashku me procedurat përkatëse, për ta rritur profesionalisht stafin akademik në mësimdhënie, mësimnxënie dhe vlerësim, duke marrë parasysh praktikën më të mirë aktuale. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë karakteristikë të praktikës së mirë dhe nuk bëri asnjë pohim.

Universiteti i përmbush kryesisht standardet për Studentët dhe Mbështetjen e tyre. Universiteti ofron udhëheqje, këshillim, tutorim dhe mbështetje të formave të ndryshme për studentët e ardhshëm dhe ata aktualë, dhe kur është e mundur, edhe për studentët me nevoja të veçanta ose ata që u përkasin pakicave të pafavorizuara. Studentëve iu vihet në dispozicion një bibliotekë mjaft e pasur. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm pohoi veprimet që po ndërmerren universiteti për rritjen e angazhimit të studentëve përmes zgjedhjeve për Këshillin e ri Studentor, dhe për krijimin e bazës së të dhënave alumni dhe punën për plotësimin e saj. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë praktikë të mirë, nuk identifikoi asnjë dobësi dhe nuk dha asnjë rekomandim.

Përmbledhje e gjetjeve

Praktika e mirë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë karakteristikë të praktikës të mirë.

Dobësitë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi dobësitë e mëposhtme:

- mospërmbushja e standardeve lidhur me raportin hapësirë/student dhe papërshtatshmëria e kushteve të akomodimit dhe ambienteve, të vërtetuara me fakte (pika 2.17; **Kapitulli III, Standardi V.1**)
- mungesa e një qasjeje efikase mbarë universitare për nxitjen e përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies, si për anëtarët e rinj të personelit, ashtu edhe për ata me përvojë (pikat 4.10; **Kapitulli I, Standardi II.4**).

Rekomandimet

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm dha rekomandimet e mëposhtme:

- marrja e masave për garantimin e përmbushjes së standardeve të kërkuara në lidhje me hapësirën fizike (pika 2.17; **Kapitulli III, Standardi V.1**)
- vënia në punë e një sistemi efikas së bashku me procedurat përkatëse për rritjen profesionale të stafit akademik në mësimdhënie, mësimnxënie dhe vlerësim, duke marrë parasysh praktikën më të mirë aktuale (pika 4.10; **Kapitulli I, Standardi II.4**).

Pohimi i veprimeve të ndërmarra

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm pohon veprimet e ndërmarra si më poshtë:

- hapat që po ndërmerren për përforcimin e këshillimit të pavarur të jashtëm në punën e NjSBC-së (pika 1.7; **Kapitulli III, Standardi I.4**)

- punën e universitetit në hartimin e strategjisë së tij të (pika 1.9; **Kapitulli III, Standardi I.5**)
- masat që po merren për të garantuar realizimin e 70 përqindëshit të ngarkesës mësimore nga ana e stafit me kohë të plotë në studimet e ciklit të parë dhe të dytë (pika 3.8, 3.9 dhe 1.12 **Kapitulli I Standardi I.9**)
- masat që po merren për zgjedhjen e Këshillit të ri Studentor, i cili do të zyrtarizojë dhe përmirësojë pjesëmarrjen e studentëve në jetën institucionale (pika 5.11; **Kapitulli I Standardi III.7**)
- krijimin e një baze të dhënash alumni nga Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe plotësimi sistematik i saj (pikat 5.13 dhe 1.17; **Kapitulli I Standardi III.9**).

Përmbledhje e gjykimeve për çdo Fushë Vlerësimi

- 1 Standardet për Organizimin dhe Menaxhimin e tij janë **përbushur kryesisht**.
- 2 Standardet për Burimet janë **përbushur pjesërisht**.
- 3 Standardet për Kurrikulën janë **përbushur kryesisht**.
- 4 Standardet për Mësimdhënien, Mësimnxënien, Vlerësimin dhe Kërkimin janë **përbushur kryesisht**.
- 5 Standardet për Studentët dhe Mbështetjen e tyre janë **përbushur kryesisht**.

Gjykim i përmbledhur

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm i rekomandon Këshillit të Akreditimit se në Universitetin e Shkodrës, Standardet Shtetërore të Cilësisë janë **përbushur kryesisht**.

Raporti i detajuar

Fusha e Vlerësimit 1: Organizimi dhe Menaxhimi i tij

- 1.1 Universiteti i Shkodrës (USH) është një institucion publik i arsimit të lartë, i krijuar me Vendimi të Këshillit të Ministrave në vitin 1991. Kuadrot e tij rregullatore dhe drejtuese janë hartuar në mënyrë të tillë që të përafrohen me kriteret ligjore kombëtare për arsimin e lartë. **[RVV fq.9-11]** Statuti i universitetit përkon me misionin e institucionit dhe pasqyron qëllimin e tij. **[1.2]** Në rregulloren e miratuar nga Senati, të quajtur "Kodi i Brendshëm i Administratës së Universitetit të Shkodrës" ofrohen hollësitë e funksionimit të administrimit të organizatës brenda Statutit, si dhe trajtohen çështje lidhur me përdorimin e vulës, strukturën administrative të universitetit, rolet dhe përgjegjësitë, si dhe protokollet e punonjësve. **[1.1]** Me kalimin e viteve, Statuti i universitetit ka ndryshuar, dhe si pasojë kanë ndryshuar edhe procedurat përkatëse të brendshme dhe të jashtme, **[1.3; 1.4]** dhe po bën ndryshime për të mundësuar përputhshmërinë me kërkesat e ligjit të ri (80/2015) dhe akteve nënligjore përkatëse, kur të bëhen të disponueshme. **[M1]** Ndërkohë, detyrat po kryhen me sukses, ku përgjegjësitë e Këshillit të Fakultetit i kalojnë Dekanatit dhe Këshillit të Profesorëve, që vazhdojnë të funksionojnë në periudhën e tranzicionit. **[M1][Kapitulli III Standardi I.1]**
- 1.2 Organet e universitetit që garantojnë drejtimin efikas janë: Senati Akademik, Rektorati, Bordi i Administrimit dhe Këshilli i Etikës. Këto organe janë përgjegjëse për vendimmarrjen kolegjiale, për të cilat njoftohet stafi i të gjitha niveleve . Siç kërkohet dhe nga Neni 14 i Statutit, Rektorati përgatit dhe paraqet buxhetin në Senat. **[RVV fq.9; 1.5]** Bordi i Administrimit mbikëqyr menaxhimin financiar dhe administrativ të universitetit, **[1.7]** ku Senati ka kompetenca akademike. **[M3]** Këshilli i Etikës jep këshilla lidhur me çështjet e etikës, dhe heton shkeljet e Kodit të Etikës së Universitetit. **[1.8]** Në nivel fakulteti, burimet, që më parë menaxhoheshin Këshilli i Fakultetit, tani menaxhohen nga Dekanati mbështetur në propozimet e departamenteve. **[1.12; M3]**
- 1.3 Vetëm njëri prej fakulteteve, Fakulteti i Shkencave Shoqërore, e ka Këshillin e Profesorëve, pasi është i vetmi që ofron aktualisht studime të ciklit të tretë. Këshilli përbëhet nga të gjithë profesorët e Fakultetit, pjesë e termave të referencave të të cilit janë dhënia e titullit "Profesor", miratimi i programeve dhe shpallja e fituesve të doktoraturave. **[1.10; 1.11]** Këshilli vazhdon të zbatojë rregulloret e përkohshme drejtuese, si forma zëvendësimi të atyre të përhershmeve. **[M1][Kapitulli III Standardi I.2]**
- 1.4 USH-ja mbështet diskutimin dhe debatin në organet kolegjiale. Mënyra e funksionimit të bordeve dhe këshillave është e qartë për të gjithë personelin dhe studentët. **[M3; M12]** Në universitet organizohen rregullisht mbledhje nga Senati dhe organe të tjera kyçe, dokumentet dhe axhendat e të cilave bëhen të ditura paraprakisht, duke i dhënë mundësi pjesëtarëve t'i shqyrtojnë dhe t'i diskutojnë çështjet që ata përfaqësojnë. **[RVV fq.10; M3; M5]** Anëtarët e Rektoratit dhe drejtuesit e nivelit të lartë në nivel fakulteti dhe departamenti janë përgjegjës për monitorimin e zbatimit të vendimeve. Universiteti publikon raportet e mbledhjeve të Senatit dhe Bordit të Administrimit në faqen e internetit të USH-së, si dhe ua dërgon ato Dekanateve dhe departamenteve për komunikim në mbledhjet në nivel departamenti. Personat të cilët u takuan me Grupin e Vlerësimit të Jashtëm, pohuan se kjo mënyrë e qarkullimit të informacionit ishte efikase. **[M12]**
- 1.5 Përfaqësuesit e studentëve të të gjitha fakulteteve që janë anëtarë të Senatit, raportuan se merrnin pjesë plotësisht në debat, duke dhënë madje shembullin e lobimit të suksesshëm për ndryshimin e propozimeve të buxhetit. **[M3] [Kapitulli III Standardi I.3]**
- 1.6 USH-ja siguron qartësinë e kufijve të autonomisë së tij dhe respektimin e saj sipas legjisllacioneve përkatëse. Vetëdrejtimi përfshin edhe organizimin e strukturave të brendshme, përkaktimin e fushave të edukimit dhe projekteve të kërkimit, si dhe përzgjedhjen e studentëve dhe stafit. Rolet e brendshme caktohen, ndërsa pozicionet kyçe si Rektori dhe Përgjegjësi i Departamentit zgjidhen.

- 1.7 Sigurimi i brendshëm i cilësisë menaxhohet nga Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NjSBC) të ngritur në vitin 2015, [1.15] e cila, në përputhje me kërkesat ligjore, vlerëson efikasitetin e mësimdhënies dhe veprimtarive kërkimore, si dhe garanton përputhshmërinë me Statutin Institucional dhe rregulloret e brendshme. NjSBC-ja ka vetëm një punonjës, por është pjesë e Degës së Kurrikulës, Kërkimit dhe Standardeve. [M2] Ajo organizon anketimet e personelit dhe studentëve lidhur me cilësinë e programeve (shihni pikën 4.5 më poshtë), rezultatet e të cilave shërbejnë si bazë për raportet e brendshme të vlerësimit të departamenteve dhe fakulteteve, [FE28] si dhe për raportin vjetor të universitetit. [M2] Njësia mbështetet nga një komision ad hoc për sigurimin e cilësisë së brendshme, i ngritur nga Rektorati në muajin janar të vitit 2017. [1.16] Universiteti pranon se, për të marrë këshilla të pavarura, në veprimtaritë dhe proceset e tij, duhet të angazhojë ekspertë të jashtëm, [RVV fq.13] gjë që ka filluar ta realizojë përmes përfshirjes së ekspertëve të jashtëm në përgatitjen dhe rishikimin e kursit të studimit. [M4] Grupi i Vlerësimit të Jashtëm **pohon** hapat që po ndërmerren për të përforcuar dhënien e këshillave nga ekspertë të jashtëm të pavarur në punën e NjSBC-së.
- 1.8 Nëpërmjet Zyrës së Marrëdhënieve me Jashtë, USH-ja ka kërkuar financim të jashtëm dhe ka përfituar nga projektet dhe programet evropiane. [1.17;1.23;1.25] Universiteti ka disa marrëveshje që mbështesin shkëmbimin dhe bashkëpunimin me universitete të tjera ndërkombëtare, dhe vlerëson ndarjen e përvojës së fituar përmes pjesëmarrjes në programet TEMPUS dhe Erasmus. [1.22;M4] **[Kapitulli III Standardi I.4]**
- 1.9 Në shkurt të vitit 2017, Senati miratoi strategjinë e re të zhvillimit për periudhën 2017-2021, [1.18] e cila përditëson strategjinë e mëparshme të periudhës 2010-2015. [RVV fq.11] Personeli me të cilin u takua Grupi i Vlerësimit të Jashtëm jo vetëm që kishin informacion për objektivat e strategjisë, por i përdornin si udhërrëfyes gjatë punës së tyre. [M2;M4] Disa prej tyre ishin përfshirë madje edhe në procesin e hartimit të saj. [M4;M10] Strategjia është në përputhje me misionin e universitetit, ku përfshihen analiza SWOT, prioritetet dhe objektivat, por nuk përmban synimet e qarta apo një plan veprimi. [1.18] Treguesit kyç të performancës përshkruhen më vete [FE14] dhe përcaktojnë matjet, si për shembull numrin e kanaleve për komunikim dhe informim, por nuk përcaktojnë qartësisht objektivat dhe afatet kohore, të cilat do t'i jepnin mundësinë universitetit të kuptonte se kur i ka realizuar objektivat e tij. Për shembull, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm zbuloi se, departamenteve iu kërkohej t'i përcaktonin prioritetet e tyre nga 30 objektivat e strategjisë dhe se arritjet e tyre kundrejt këtyre prioritetëve do të vlerësoheshin çdo vit. [M4] Grupi i Vlerësimit të jashtëm **pohon** punën e universitetit për zbatimin e strategjisë së tij të zhvillimit. **[Kapitulli III Standardi I.5]**
- 1.10 Raporti vjetor në nivel institucioni [1.19] përgatitet nga grupi i punës, duke u mbështetur në raportet vjetore të çdo fakulteti dhe i paraqitet Senatit, ku diskutohet më pas nga anëtarët e personelit dhe përfaqësuesit e studentëve. [RVV fq.11;M3] Raporti ofron hollësi për veprimtaritë e universitetit, duke përfshirë shpenzimet, prokurimet dhe të ardhurat nga tarifat shkollimit. Pas miratimit nga Senati, raporti i dërgohet Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve (MAS) dhe publikohet në faqen e internetit të universitetit. **[Kapitulli III, Standardi I.6]**
- 1.11 USH-ja ka gjashtë fakultete, të ndara në 21 departamente akademike [RVV fq.6] dhe ofron programe në tre cikle studimi. Ciklet e dyta të studimit ofrohen në të gjitha fakultetet, me përjashtim të fakultetit më të ri, Fakultetit të Gjuhëve të Huaja. [RVV fq.7] Cikli i tretë (studimet e doktoraturës) ofrohet vetëm në Fakultetin e Shkencave Shoqërore në fushën e Gjuhës Shqipe. [RVV fq.7] Universiteti ka struktura të qarta. [1.1;1.5] Fakultetet dhe departamentet janë të organizuara në përputhje me kërkesat ligjore, ndërsa strukturat drejtuese, ekzekutive dhe administrative janë të ndara nga strukturat akademike. USH-ja e ushtron lirinë akademike në mësimdhënie dhe kërkim së bashku me autonominë financiare, dhe përgjegjës për garantimin e këtyre dy parimeve është Senati. [1.2] Stafi Akademik është i pavarur në organizimin të veprimtarive akademike në mësimdhënie, kërkim shkencor, dhe në kurrikulën e programeve të studimit. [M3]
- 1.12 Stafi me kohë të plotë i universitetit përbëhet nga 200 anëtarë, të gjithë të kualifikuar në fushat e tyre të studimit. [1; GID; FE38] Kriteri që 70 për qind e stafit të mësimdhënës të programeve të ciklit të parë dhe të dytë duhet të jenë me kohë të plotë, nuk përmbushet gjithmonë nga universiteti, por ky i fundit po punon për marrjen e masave për plotësimin e tij.

(Shihni diskutimet e mëtejshme në pikat 3.8 dhe 3.9.) Faqja e internetit të USH-së ofron një larmi informacionesh, duke përfshirë shërbimin online për studentët, ku disa prej faqeve të tij ofrohen në gjuhën angleze, dhe synohet që, vitin e ardhshëm, të ofrohet i tëri i përkthyer në gjuhën angleze. [<http://www.unishk.edu.al/en>; FE5] [**Kapitulli III Standardi II.1**]

- 1.13 Siç u theksua në pikat 1.2 dhe 1.4 më sipër, organet kryesore institucionale (Senati Akademik, Rektorati, Bordi i Administrimit dhe Këshilli i Etikës) janë funksionale, dhe debati dhe diskutimet nxiten. Stafi dhe studentët kanë përfaqësimin të duhur te të gjitha këto organe. Ata raportojnë se kanë mundësi të ngrenë çështje dhe të informohen rreth vendimmarrjes për të. Si shembull dhanë masat që ishin marrë lidhur me vështirësitë në oraret mësimore që ishin caktur.
- 1.14 Grupi i Vlerësimit të Jashtëm u takua me përfaqësuesit e zgjedhur të Këshillit Studentor, të cilët raportuan se, dikur, Këshilli nuk ka qenë një organ shumë efikas, por që tani ai trajton çështje të rëndësishme dhe shqetësuese për ta, si p.sh. përvojën e të nxënit, oraret mësimore dhe çështjet rregullatore. Si përfaqësues, ata konsultoheshin me studentët e tjerë fizikisht ose përmes emailit, për t'i parashtruar shqetësimet dhe këndvështrimet e tyre. Si rrjedhojë e ngritjes së çështjeve në Këshillin Studentor, janë marrë masa. [M5][**Kapitulli III Standardi II.3**]
- 1.15 Strategjia e zhvillimit të universitetit thekson rëndësinë e trajtimit të nevojave të tregut vendas të punës. [1.18] Ndër veprimtaritë që e mbështesin këtë gjë janë përshtatja e kurrikulës për përmbushjen e nevojave të tregut, [1.24] bashkëpunimi me punëdhënësit, [M7b] këshillimi karrierës për studentët dhe pjesëmarrja në konferenca për zhvillimin rajonal. [RVV fq.12]
- 1.16 Zyra e Këshillimit të Karrierës u krijua në dhjetor të vitit 2016, [1.21] e cila përbëhet nga një drejtues (profesor) dhe tre studentë. [1.21] Ajo ofron këshillim karriere për studentët dhe informacione rreth mundësive të punësimit. Gjithashtu, ajo punon me disa punëdhënës për lehtësimin e mundësive të punësimit dhe për organizimin e panairëve të punës, si dhe i ofron informacione rreth tregut të punës kolegëve që po përgatisin kurse të reja. [M12] Studentët me të cilët u takua Grupi i Vlerësimit të Jashtëm kishin dijeni për këtë zyrë, dhe pohuan faktin se ajo ishte krijuar së fundmi, ndonëse Fakulteti i Ekonomikut ofronte disa shërbime të ngjashme. [M7b] [**Kapitulli III Standardi III.1**]
- 1.17 Universiteti e monitoron punësimin e studentëve të diplomuar përmes departamenteve një vit pas diplomimit të tyre, dhe kohët e fundit ka krijuar një bazë qendrore të dhënash në Zyrën e Këshillimit të Karrierës, ku aktualisht ruhet informacion për rreth 700 të diplomuar. [M14] Megjithatë, ruajtja sistematike e këtyre të dhënave është vetëm në fazat e para. (shihni pikën 5.13).
- 1.18 Ndërkombëtarizimi është një prej gjashtë prioriteteve kryesore të universitetit, të përfshira në Strategjinë e Zhvillimit [1.18] dhe në disa marrëveshje partneriteti me IAL-të jashtë vendit, [1.22; 1.23] të cilat kryejnë veprimtari kërkimore. Ndër planet e mëtejshme të universitetit përfshihen skemat e bursave, partneritetet (rajonale dhe globale), kurrikula e ndërkombëtarizuar, ndërmarrja e kërkimit në bashkëpunim me palë të tjera, dhe mobiliteti i stafit akademik. [1.18]
- 1.19 Në nivel rajonal, USH-ja ka marrëdhënie të ngushta me punëdhënësit, dhe gjatë takimeve me Grupin e Vlerësimit të Jashtëm, partnerët e jashtëm pohuan se, për përgatitjen e kurseve të reja apo rishikimin e atyre ekzistuese, universiteti iu kishte kërkuar këshilla në lidhje me ekonominë vendore dhe kërkesat e tregut. [RVV fq.12; 1.24; M7a; M7b; M12] [**Kapitulli III Standardi III.2**]
- 1.20 Për të mundësuar stazhin e studentëve, universiteti punon me disa organizata të sektorëve të ndryshëm. [RVV fq.12; 1.26] Nga takimet me studentët dhe partnerët e jashtëm doli që lidhjet e ngushta dhe marrëdhëniet e afërta me punëdhënësit vendorë dhe rajonale ishin në të mirë të studentëve, pasi këto organizata ofrojnë shumë mundësi. [1.26; M5; M7b] Disa prej shembujve të këtyre mundësive të ofruara nga partnerët e jashtëm dhe studentët përfshinin: stazhet në banka dhe bashki, vendosjen në praktikë të studentëve të infermierisë në spitale,

vëzhgimet e seancave gjyqësore për studentët e drejtësisë, projektet "e drejtpërdrejta", ndihmë për rrjetëzimin dhe përgatitjen e intervistave.[M5; M7b][**Kapitulli III Standardi III.3**]

1.21 Strategjia e Zhvillimit të Universitetit, në identifikimin e ndërkombëtarizimit si një prej prioriteteve kryesore përcakton si objektivi "rritjen, nxitjen dhe mbështetjen e mobilitetit të studentëve, personelit dhe kërkuesve".[1.18] Plani i veprimit për këto objektiva parashtrohet në Strategjinë e Ndërkombëtarizimit të Universitetit 2017-2020 [FE5]. Ky plan mbështetet në veprimtaritë ekzistuese, përkatësisht në pjesëmarrjen e USH-së në programet e BE-së, që nxisin mobilitetin e personelit dhe studentëve;[RVV fq.12; 1.25; FE15] si dhe në pjesëmarrjen dhe organizimin e konferencave ndërkombëtare.[1.27] Dega e Marrëdhënieve me Jashtë ofron mbështetje dhe këshilla për projektet e financuara nga Bashkimi Evropian nën skemën e Erasmusit, apo skemave të ngjashme me të.[RVV fq.10] Pjesëmarrja në skema të tilla u pohua nga personeli dhe studentët, të cilët u takuan me Grupin e Vlerësimit të Jashtëm.[M4;M5] Në mënyrë të veçantë, stafi raportoi se, përmes përfshirjes në skema të tilla, kishin përveçuar metodat e mësimdhënies në universitetet evropiane.[M4] Universiteti ka përfituar edhe nga stafi ndërkombëtar i ftuar, të cilët janë përfshirë në mësimdhënie, duke mbështetur stafin e ri të USH-së dhe përgatitjen e kurrikulës.[FE16] Studentëve të rinj iu ofrohen disa module në gjuhën angleze.[FE5] [**Kapitulli III Standardi III.4**]

Gjetjet

Praktika e mirë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë karakteristikë të praktikës së mirë.

Dobësitë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë dobësi.

Rekomandimet

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk dha asnjë rekomandim.

Pohimi i veprimeve të ndërmarra

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm pohoi veprimet e ndërmarra si më poshtë:

- hapat e ndërmarra për përforsimin e këshillimit të ekspertëve të jashtëm të pavarur për punën e NjSBC-së (pika 1.7; **Kapitulli III Standardi I.4**)
- puna e universitetit në zbatimin e Strategjisë së tij të Zhvillimit (pika 1.9; **Kapitulli III, Standardi I.5**).

Gjykimi

Standardet për Organizimin dhe Menaxhimin e tij janë përmbushur kryesisht.

Fusha e Vlerësimit 2: Burimet

- 2.1 Universiteti ndjek një politikë rekrutimi të qartë, të hapur dhe të drejtë për të gjitha kategoritë e personelit. **[1.2 Kapitulli 7; 2.2]** Vendet e lira të punës dhe kriteret e emërimit publikohen në faqen e internetit të universitetit dhe të Zyrës së Prokurimit Publik. **[2.3; 2.4]** Personeli përshkroi proceset e emërimit të tyre, të cilat ishin në përputhje me kriteret e parashtruara në politikën e punësimit. **[M14]** Qasja e universitetit për planifikimin e burimeve të mësimdhënies drejtohet nga departamentet. Në qershor të çdo viti, çdo departament parashtron kriteret për vitin e ardhshëm akademik. Aplikimet shqyrtohen përpara se t'i kalojnë Rektoratit për miratim. Universiteti synon të punësojë 70-80 për qind të personelit të tij me kohë të plotë, ndërsa pjesën tjetër me kohë të pjesshme (shihni pikën 3.8 më poshtë), gjë që ofron fleksibilitet dhe kontroll në mbulimin e lëndëve. Universiteti përpiqet të tërheqë akademikë nga universitetet perëndimore (shihni pikën 2.4 më poshtë), si dhe **[2.6; RVV fq.15]** përpiqet ta përdorë Këshillin e Profesorëve si mjet për ngritjen në detyrë të personelit të brendshëm, në pritje të publikimit të akteve të reja nënligjore. **[2.5]** Ai e publikon strukturën e tij organizative dhe dokumentet kryesore rregullore në faqen e internetit. [\[http://www.unishk.edu.al/en/node-110\]](http://www.unishk.edu.al/en/node-110) **[Kapitulli III Standardi IV.1]**
- 2.2 Universiteti nuk ndjek një qasje të qendëruar për orientimin e anëtarëve të rinj të personelit. Megjithatë, gjatë takimeve, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm u informua se fakultetet caktonin një pedagog të ri pranë një profesori me përvojë në disiplinën e tyre, në mënyrë që të vëzhgonin se si ky profesor i organizonte seminarët dhe leksionet. Anëtari i ri mbikëqyrej gjatë mësimdhënies dhe mentorohej nga një profesor. **[M3;M12]** Kjo pikë shtjellohet më tej në pikën 4.10, në të cilën jepet edhe rekomandimi që universiteti të miratojë një politikë të zakonshme dhe të qëndrueshme për orientimin e stafit të ri të të gjitha departamentet. Universiteti ofron aktivitete sociale dhe integruese të organizuara nga vetë institucioni, ku përfshihen konferenca akademike, aktivitete dhe veprimtari për studentët, ditët e hapur dhe organizimet e festave. **[2.7]** Informacioni me shkrim i jepet stafit të ri në formën e shkresave informuese nga departamenti, udhëzuesit për studentët dhe informacionit të përgjithshëm. **[2.8] [Kapitulli III Standardi IV.2]**
- 2.3 Universiteti ka publikuar Strategjinë e Zhvillimit për periudhën 2017-2020 **[1.18]**, në të cilën parashtrohet misioni dhe vizioni i universitetit, së bashku me disa fusha të gjera dhe objektiva për të ardhmen. Këto objektiva lidhen me veprimtaritë zhvillimore që personeli nxitet të ndërmarrë për të mbështetur strategjinë. **[1.17; 1.27; 2.10]** Kjo strategji mbështetet në nivel më analitik nga një grup vlerësimesh, duke përfshirë edhe Analizën për Punën Arsimore për vitin 2015-2016, **[1.27]** e cila mbulon një mori aktivitete pedagogjike dhe veprimtarish pedagogjike të universitetit dhe personelit të tij, si dhe mbështetet në disa raporte përmbledhëse në shkallë departamenti. **[2.5;2.11;3.17;4.7;4.15]**
- 2.4 Universiteti po zhvillon më tej qasjen e tij për vlerësimin e performancës së personelit. Grupit të Vlerësimit të Jashtëm iu tha se, fakultetet, në fund të çdo semestri, organizojnë anketime për performancën e anëtarëve të stafit në veçanti dhe për programin në tërësi. Anketimet dorëzoheshin më pas në Dekanat për shqyrtim. Dekani përgatiti një raport të përgjithshëm, i cili i dorëzohet Senatit përmes zyrës më të re, Drejtorisë së Kurrikulave, Kërkimit Shkencor dhe Standardeve. **[M12]** Deri më sot, qasja e universitetit i është deleguar fakulteteve, dhe si rrjedhojë nuk është ndjekur në mënyrë sistematike ose të qëndrueshme. Universiteti e ka identifikuar këtë si dobësi dhe si fushë që ka nevojë për zhvillim të mëtejshëm. **[1.27]** Ka fakte që tregojnë se universiteti rekruton vazhdimisht personel nga universitetet perëndimore dhe nxit personelin e tij të fitojë përvojë në universitetet perëndimore. Universiteti ka lidhur 39 marrëveshje bashkëpunimi me universitete të tjera në nivel ndërkombëtar, si dhe ka marrë pjesë në 36 projekte ndërkombëtare dhe në projektet CEEPUS dhe TEMPUS. **[1.22; 1.23;2.11, M12]** Megjithatë, universiteti ka vënë re se numri i tyre ka pësuar ulje këtë vit, për shembull vetëm tre anëtarë personeli vijnë nga universitete të huaja dhe vetëm dy prej tyre janë të ftuar, nga 5 që kishin në vitin 2015. Universiteti ka vënë në dukje që duhen bërë më shumë përpjekje në këtë fushë, dhe ka theksuar ndërkombëtarizimin në Planin e tij Strategjik 2017-2022. **[1.27][Kapitulli III Standardi IV.3]**

- 2.5 Universiteti dhe studentët organizojnë veprimtari sociale dhe nxisin dialogun social përmes një sërë aktiviteteve që përfshijnë: panaire, debate, aktivitete sportive dhe artistike, bamirësi, veprimtari komunitare, dhe ndërgjegjësim. **[RVV fq.16 linqet në internet; 1.23-1.27;2.12; 4.23 - 4.27]** Në përputhje me ligjet shtetërore, universiteti i ofron personelit sigurime shëndetësore dhe sociale. **[FE7; FE11] [Kapitulli III Standardi IV.4]**
- 2.6 Universiteti siguron menaxhimin efikas të burimeve njerëzore, duke specifikuar rregullat dhe përgjegjësitë për funksionet e BNJ-së në Statut dhe Rregulloret Administrative të administruara nga Dega e Burimeve Njerëzore, që përbëhet nga drejtori dhe dy specialistë. **[1.1; 1.2; 2.2]** Të drejtat dhe detyrimet kontraktuale për çdo punonjës parashtrihen në kushtet e kontratës së tyre të punësimit dhe të përshkrimi i pozicionit të punës. **[2.4.2; 2.4.5; 2.6]** Ngarkesa e punës dhe performanca vlerësohen çdo vit, gjë që lë vend për përshtatje lidhur kushtet e punësimit, si p.sh. orët dhe temat që do të trajtohen. Kontratat e punës përgatiten nga Dega e Burimeve Njerëzore, e cila mbikëqyr ruajtjen dhe vlefshmërinë e tyre. **[1.1]** Në raportin e auditit të brendshëm, **[FE10]** raportohen disa shkelje të praktikave të miratuara në emërimin dhe kompensimin e stafit, të cilat vijnë si rrjedhojë e mosnjohjes së kërkesave statutores dhe mungesës së komunikimit të brendshëm efikas midis grupeve të ndryshme në universitet. Këto probleme janë trajtuar nga një plan veprimi dhe janë raportuar në Raportin Vjetor. **[1.19] [Kapitulli III Standardi II.2]**
- 2.7 Në përputhje me kriteret statutores, universiteti përdor një model buxhetafi afatmesëm trevjeçar, që rishikohet dhe ndryshohet çdo vit. **[RVV fq.17; 1.19; FE7; FE8; FE9]** Strukturat për përcaktimin, përgatitjen dhe shqyrtimin e buxhetit janë në përputhje me rregulloret statutores. Buxheti kalon nga lartë poshtë, ku propozimet e departamenteve dhe njësive administrative të fakulteteve përcillen te Kancelari. Hartimi i buxhetit administrohet nga Kancelari dhe Drejtoria e Financës së universitetit, dhe i dërgohet Senatit Akademik për shqyrtim dhe miratim përmes Kancelarit. Pas miratimit nga Senati, buxheti i detajuar i paraqitet Bordit të Administrimit për miratim, dhe së fundi i kthehet sërish fakultetit dhe departamentit për zbatim. **[1.5] [Kapitulli III Standardi VI.1]**
- 2.8 Universiteti ka një strukturë e cila mbështet dhe zbaton politikën e tij financiare. Rolet dhe përgjegjësitë lidhur me procesin e buxhetit përcaktohen në Kreun VII të Statutit të Universitetit. **[1.2]** Kancelari është përgjegjës për zbatimin e politikës financiare nga pikëpamja operacionale, i ndihmuar edhe nga Drejtoria e Financës. **[1.1]** Politika financiare rishikohet në mënyrë kolegjiale nga Senati dhe Bordi i Administrimit, që përbëhet nga persona me ekspertizën e duhur, duke përfshirë dhe përfaqësues të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit. Përgjegjëse për zbatimin e rregullave të kontabilitetit është Drejtoria e Financës. Raporti Vjetor i Monitorimit dhe dokumenti i Politikave të Auditit të Brendshëm **[1.19; 2.13; FE10]** vërtetojnë se zbatimi i politikave financiare është rishikuar dhe mbikëqyruar me kujdes.
- 2.9 Raporti Vjetor **[2.13]** i referohet edhe auditit të jashtëm të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, **[FE10]** i cili identifikoi disa probleme lidhur me administrimin e buxhetit, duke përfshirë edhe mungesën e Bordit të Administrimit, pagesat e pedagogëve të jashtëm dhe disa pedagogëve të fakultetit të drejtësisë, si dhe afatet e plotësimit të vendeve të lira të punës. Në të deklarohet se fakultetet nuk i kishin përmbushur disa kriteret ligjore. Megjithatë, dokumentet e dorëzuara, dhe trekëndëzimi i tij me, për shembull, miratimin e kuotave për projektbuxhetin e periudhës 2017-2019, vërtetojnë se këto probleme po trajtohen dhe se planifikimi dhe zbatimi janë të përshtatshëm. **[Kapitulli III, Standardi VI.2]**
- 2.10 Universiteti ka politikat dhe mekanizmat e duhura për mbështetjen e kontrollit buxhetor dhe financiar. Përgjegjësitë e Njësive të Auditimit përcaktohen në Rregulloret e Brendshme të Administratës. **[1.1 Neni 25]** Njësia e Auditimit ndërmerr audite të brendshme të rrepta, që përmbillen me një raport analitik dhe një plan veprimi për Rektorin, dhe diskutohen më pas në mbledhjet me personelin dhe anëtarët e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit. **[FE10]** Krahas auditeve të brendshme, universiteti i nënshtrohet edhe auditeve të jashtme nga Institucioni Shtetëror i Auditimit dhe Ministria e Arsimit dhe Sportit, **[RVV fq.18]**, përfundimet e të cilave përfshihen në Raportin Vjetor. **[1.19]** Në të gjitha rastet, përfundimet e auditit i paraqiten organeve kolegjiale, duke përfshirë Bordin e Administrimit, Senatit dhe fakultetet. **[Kapitulli III, Standardi V.3]**

- 2.11 Sistemi i menaxhimit të informacionit të universitetit është efikas në mbështetjen që i ofron personelit, studentëve dhe administratës. Si anëtar i Rrjetit Akademik Shqiptar (RASH), në vitin 2013, universiteti arriti të vinte në punë sistemin ESSE3 IRIS për nevojat e mësimdhënies, kërkimit dhe administratës, përpara të cilit ekzistonte një sistem shkresor manual. Përmes këtij sistemi, universiteti mban lidhje me Agjencinë Kombëtare të Provimeve, i cili e lejon të mbledhë të dhëna për aplikantët. Të dhënat e universitetit i dërgohen Ministrisë së Arsimit dhe Sportit përmes sistemit ESSE3. **[2.14]** Ky i fundit vlerësohet për kontributin që ka dhënë për funksionimin sa më efikas të universitetit dhe ofrimin e informacioneve më të mira. **[RVV Analiza SWOT ; M14]** ESSE3 ruan profilet e studentëve, të cilat ofrojnë informacione lidhur me programet e studimit, oraret mësimore dhe kalendarët e provimeve të studentëve, të shoqëruar dhe me rezultatet e provimeve. Studentëve iu jepet mundësia t'i shohin të gjitha këto përmes llogarive personale. **[RVV fq.18;FE3;vlerësimi gjatë vizitës]** Sistemi nuk përmban ende të dhëna personale, apo hollësi dhe materiale rreth kurrikulës, por kjo gjë pritet të realizohet në të ardhmen. Ndërkohë, departamentet kanë zhvilluar kanalet e tyre për lehtësimin e shpërndarjes së materialeve online, për shembull, Departamenti i Matematikës ka krijuar një aplikacion që lejon aksesin online, ndërkohë departamenti e tjera përdorin burime si cloud-in ose emailin. **[M14]** Universiteti publikon të gjithë informacionin kryesor akademik dhe rregullator në faqen e tij të internetit, duke përfshirë dhe të dhëna për studentët e pranuar. **[RVV fq.18;vlerësimi gjatë vizitës] [Kapitulli III Standardi VII.1]**
- 2.12 Departamenti i Teknologjisë së Informacionit mbështet dhe koordinon strukturat e IT-së, të cilat, krahas pajisjeve të stafit akademik dhe personelit administrativ, përfshijnë 407 kompjuterë të shpërndarë në laboratorët e ambienteve të universitetit. **[GID; turi]** Anketimi i APAAL-it për studentët zbuloi nivelin relativisht të lartë të pakënaqësisë rreth mundësive të përdorimit të kompjuterëve dhe cilësisë së lidhjes së internetit. Departamenti i Teknologjisë së Informacionit kryen verifikimet e tij, të cilat përmbledhen në raportin e Infrastrukturës së TIK-ut të USH-së, ku përshkruhen struktura dhe gjendja e burimeve të IT-së dhe jepen rekomandime për riparime dhe përmirësime. **[2.14]** Gjatë vizitës, studentët pohuan varësinë e cilësisë së ofrimit të internetit nga godina, por u shprehën se shërbimi i ofruar nga IT-ja ishte i pranueshëm. **[APAAL, Anketim i Studentëve; M5; 45,9] [Kapitulli III Standardi VII.2]**
- 2.13 Universiteti i menaxhon pasuritë e tij të paluajtshme siç duhet, sipas kufizimeve të burimeve financiare që ka në dispozicion. Universiteti mban një regjistër për pasuritë e tij të paluajtshme dhe ka ndjekur një plan afatmesëm për ndërtimin e një godine të re dhe rinovimin e godinave ekzistuese. **[2.15]** Godinat e Fakulteteve të Edukimit dhe Shkencave Natyrore janë rinovuar, godina e re e Fakultetit të Ekonomisë është pranë përfundimit, ndërsa godinat e tjera të universitetit do të rinovohen gjatë tre viteve në vijim. **[RVV fq.19]** Menaxhimi dhe mirëmbajtja e pasurive të paluajtshme të universitetit mbështetet nga Dega e Investimeve. **[1.1 Neni 31]** Ndonëse ekzistojnë dokumente për një qasje të planifikuar strategjike dhe funksionimi për menaxhimin e pasurive të paluajtshme, universiteti pranon që kjo qasje nuk i përmbush standardet e parashikuara në lidhje me raportin e hapësirës për student, siç përmendet edhe në pikën 2.17 më poshtë. **[1.18, 17-19; 2.16; 2.17; M5; M10] [Kapitulli III Standardi VII.3]**
- 2.14 Universiteti ka burimet dhe politikat e duhura për të mbledhur, ruajtur, mbrojtur dhe zhvilluar trashëgiminë e tij kulturore dhe shkencore. Biblioteka është përgjegjëse për katalogimin e teksteve shkencore dhe kulturore të universitetit, për mbrojtjen e botimeve në format të shtypur dhe për digjitalizimin e tyre me qëllim krijimin e një burimi të përhershëm dhe të aksesueshëm. Një prej kushteve të krijimit të bibliotekës në vitin 1957, ishte që t'i shërbente jo vetëm studentëve të universitetit, por edhe komunitetit. Si pjesë e këtij shërbimi, biblioteka ka mbledhur dhe ka ruajtur materiale që, në rast të kundërt, do të ishin shkatërruar ose do të kishin humbur. Si rrjedhojë, sot kjo bibliotekë ka një koleksion librash dhe materialesh të rralla. Në vitin 2010, ajo ndërmori projektin e digjitalizimit për ruajtjen dhe mundësimin e aksesueshmërisë si të koleksionit të rrallë, ashtu edhe të materialeve standarde. Ky projekt u përforcua më tej në vitin 2013, me futjen e një teknologjie të re në bashkëpunim me Bibliotekën "Marin Barleti". **[2.14]** Arkiva digjitale ka mbi 70.000 faqe dhe ka vlerë të veçantë në fushat e Albanologjisë, Ballkanologjisë dhe Gjuhësisë. **[RVV fq.19; M14; 1.1 Neni 34; 2.17; Turi][Kapitulli III Standardi VII.4]**

- 2.15 Ka prova të qarta se universiteti ndjek një qasje strategjike dhe praktike për menaxhimin e aseteve të tij. Në nivel strategjik, universiteti ka procedura dhe dokumente të politikave gjithëpërfshirëse, si p.sh. Statutin e Universitetit, Rregulloren e Administrimit dhe Planin Strategjik. [1.1; 1.2; 1.6; 1.18] Këto mbështeten në nivel praktik dhe fakulteti nga të dhëna si p.sh Tabela e Infrastrukturës, [2.15] lista e aseteve të TI-së, [2.14] dhe të dhënat e pajisjeve brenda institucionit. [2.19] Mbikëqyrja dhe zbatimi operacional arrihen përmes planeve të detajuara, si kërkimi për frekuentimin e bibliotekës, [2.12.1] kërkesat me shkrim për bibliotekën, [5.11] dhe të dhënat e kostove për projektet e infrastrukturës dhe godinave. [2.16] Më pas, analiza e këtyre planeve dhe dokumenteve shërben si bazë për dokumentet më gjithëpërfshirëse përmes procesit të vlerësimi si p.sh për Raportin Vjetor [1.19] dhe analizën SWOT, që i bashkëlidhet RVV-së. [RVV fq.52-53] [Kapitulli III Standardi VII.5]
- 2.16 Universiteti angazhohet në nivel rajonal dhe kombëtar në fusha me interes të përbashkët. Ekzistojnë dokumente për studimin e tregut dhe ofrimin e shërbimeve, [1.24; 2.19] si dhe marrëveshje dhe projekte të vazhdueshme bashkëpunimi me universitete, punëdhëns dhe organe të tjera. [1.17; 1.22] Partnerët e jashtëm përshkruajnë disa përfitime që rrjedhin nga bashkëpunimi i tyre me universitetin, si: shkëmbimi i njohurive, vlerësimi i tregut dhe sektorit të punës, përditësimi i praktikës dhe zhvillimi i talenteve. [M6] Gjatë përgatitjes së kurseve të reja, stafi akademik merr parasysh nevojat e tregut të punës dhe ato rajonale. [M10] Disa prej këtyre veprimtarive mbështeten në nivel qendror nga disa njësi administrative, si p.sh Dega e Marrëdhënieve me Jashtë. Megjithatë, del se, pjesa më e madhe e nismave udhëhiqet nga fakultetet ose vetë departamentet, pa mbështetjen ose koordinimin qendror dhe zyrtar të universitetit. [Kapitulli III, Standardi VII.6]
- 2.17 Universiteti përdor tetë godina që ndodhen në zona të ndryshme të qytetit të Shkodrës, të cilat ndryshojnë nga kushtet dhe vjetërsia. Universiteti është i ndërgjegjshëm për mangësitë dhe kufizimet e akomodimit dhe ambienteve të tij, ndaj ka ndërmarrë një program të planifikuar për ndërtesa të reja, rinovim dhe ristrukturim, përmes të cilit do të trajtohen disa prej këtyre mangësive. Aktualisht, sipërfaqja e universitetit është 19.600 m², e cila do të rritet në 25.400 m² pas përfundimit të godinës së re të Fakultetit të Ekonomisë. Megjithatë, me pothuajse 13,000 studentë, standardi i raportit të hapësirës për student të përmendur në **Kapitullin III Standardi V.1** nuk është përmbushur, gjë që pranohet dhe nga vetë universiteti. [GID; M10] Zyrat e personelit janë të përbashkëta dhe të mbingarkuara, dhe mungojnë ambientet për stafin me kohë të pjesshme, për mbikëqyrjen e studentëve ose për mbledhjet këshillimore. Grupi mori informacion rreth rrugëve që ndiqte universiteti dhe personeli i tij për përmirësimin e këtyre problemeve përmes përcaktimit të orareve, dhe vuri re se universiteti ishte i hapur 12 orë në ditë, gjatë të shtatë ditëve të javës. [2.15; **Turi**] Gjithashtu, universiteti pranon se, në disa prej godinave të tij, ka probleme me praninë e burimeve që lidhen me ajrin e kondicionuar, sistemet moderne të parandalimit të zjarrit, ambientet e mësimdhënies, TI-së, hapësirat e mjaftueshme për sallat e seminareve, rrugët ndihmëse dhe ambientet për studentët me aftësi të kufizuara. [2.14; 2.15; M5; RVV SWOT] Grupi i Vlerësimit të Jashtëm e konsideron mospërmbushjen e standardit për hapësirën dhe kushtet e ndryshme të akomodimit dhe ambienteve si **dobësi**. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm pohon masat që ka marrë universiteti për përmirësimin e infrastrukturës së tij, dhe pranon dilemën se ulja e studentëve të rinj për të përmbushur standardet e hapësirës dhe të infrastrukturës do të ndikonte negativisht të ardhurat që kërkohen për pagimin e përmirësimeve të nevojshme. Megjithatë, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm **rekomandon** marrjen e masave nga ana e universitetit për garantimin e përmbushjes së standardeve të kërkuara lidhur me hapësirën fizike. [Kapitulli III Standardi V.1]
- 2.18 Universiteti ka njësi të posaçme për ruajtjen e shkresave si në format të shtypur, ashtu edhe në format elektronik, të cilat zbatojnë rregulloret për menaxhimin dhe arkivimin e dokumenteve. [5.10] Sektori i Protokollit dhe Arkivës ruan të gjithë korrespondencën dhe shkresat e universitetit. Dega e Informacionit dhe Teknologjisë është përgjegjëse për sistemimin e të gjitha të dhënave statistikore, të kërkuara me ligj. Të dhënat individuale të studentëve ruhen nga sekretaritë e fakulteteve, [RVV fq.22] ESSE3 ofron një bazë elektronike të të dhënave të studentëve. [AE3; Vlerësim i bazës së të dhënave] [Kapitulli III Standardi V.2]

Gjetjet

Praktika e mirë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë karakteristikë të praktikës së mirë.

Dobësitë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi dobësinë e mëposhtme:

- mospërbushja e standardeve lidhur me hapësirën dhe kushtet e ndryshme të akomodimit dhe ambienteve (pika 2.17; **Kapitulli III, Standardi V.1**).

Rekomandimet

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm dha rekomandimin e mëposhtëm:

- marrja e masave nga ana e universitetit për garantimin e përbushjes së standardeve të kërkuara lidhur me hapësirën fizike (pika 2.17; **Kapitulli III, Standardi V.1**).

Pohimi i veprimeve të ndërmarra

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk pohoi asnjë veprim të ndërmarrë.

Gjykimi

Standardet për Burimet janë përbushur pjesërisht.

Fusha e Vlerësimit 3: Kurrikula

- 3.1 Në deklaratën e Misionit të tij, **[1.2]** USH-ja njih vlerat që ka në fushën e mësimdhënies dhe arsimimit. Programet e ciklit të tretë (Doktoratura) ofrohen vetëm për doktoraturën në Gjuhë Shqipe, në Fakultetin e Shkencave Shoqërore. Kriteret e pranimit të studentëve pasi përcaktohen, publikohen, **[3.7; 3.8]** ndërsa aftësitë e studentëve provohen, duke përdorur rregulloret e duhura. **[3.6]** **M14** Universiteti i jep mundësi publikut të informohet rreth programeve të ofruara të studimit përmes organizimit të seancave të orientimit në fillim të çdo semestri, publikimit të informacioneve në faqen e internetit **[RVV fq.23]** dhe organizimit të ‘Ditëve të hapura’. **[3.3; M5a;M14]** Institucioni ofron manuale për studentët e cikleve të para, të dyta dhe të treta. **[FE41]****[Kapitulli I Standardi I.1]**
- 3.2 Që prej krijimit të saj në mars të vitit 2015, Qendra e Ekselencës ka ofruar vazhdimisht shërbime në formën e të nxënësve gjatë gjithë jetës. **[3.10; 3.11; FE18]** Gjithashtu, ajo ofron shërbime në formën e moduleve të formimit në Departamentin e Edukimit, Departamentin e Infermierisë dhe Fakultetin e Ekonomisë. **[3.12]** Deri në vitin akademik 2013-2014, universiteti ofronte programe studimi me kohë të pjesshme, por duke qenë se ndryshimet që pësoi ligji në vitin 2014 e ndaluan ofrimin e tyre, pranimi i studentëve për këto programe u mbyll. **[RVV fq.25]** NjSBC-ja bën pyetësorë për të marrë feedback për aspekte të ndryshme të vënies në praktikë të programeve të studimit. **[3.13]** **[Kapitulli I Standardi I.2]**
- 3.3 Portofoli i programeve të ofruara nga universiteti përputhet plotësisht me Strategjinë e Zhvillimit 2017-2021. **[1.18]** Universiteti e konsideron përmirësimin e mëtejshëm të shërbimit si objektiv strategjik, e cila mund të realizohet përmes dhënies, krijimit, mbrojtjes dhe transmetimit të njohurive nëpërmjet mësimdhënies sipas parimeve të Kartës së Bolonjës, si dhe kërkimit shkencor, formimit të specialistëve dhe përgatitjes së shkencëtarëve të rinj. **[1.2]** Siç shprehet dhe në Strategjinë e Zhvillimit 2017-2021, USH-ja e ka identifikuar tregun e punës si një prej prioritetëve të saj, duke synuar përshtatjen e kurrikulave sipas nevojave të tregut të punës, bashkëpunimin e ngushtë me punëdhënësit dhe orientimin e studentëve për kërkesat e tregut të punës. **[1.18; M4]** Krahas kësaj, në shkurt të vitit 2017, universiteti krijoi një strategji mësimdhënieje dhe një strategji kërkimi për tregun e punës, me qëllim përshtatjen e veprimtarisë mësimdhënëse me prirjet bashkëkohore dhe integrimin e kurrikulës me nevojat e tregut të punës. **[3,10; 3.11]** **[Kapitulli I Standardi I.3]**
- 3.4 Programet e studimit të USH-së ofrohen në përputhje me prirjet vendore dhe kombëtare. Universiteti përpiqet të sigurojë përputhshmërinë me prirjet ndërkombëtare. Strategjia e Zhvillimit të Universitetit 2017-2021 dhe Strategjia Ndërkombëtare përcaktojnë qartë qëllimin e universitetit për vijimin e angazhimit në ndërkombëtarizim. **[1.18]** Strategjia Ndërkombëtare përfshin programet e ofruara në gjuhën angleze dhe marrëveshjet e nënshkruara për zhvillimin e kurrikulës ndërkombëtare. **[FE5]** Propozimet e kurrikulës së re mbështeten në ekonominë vendore dhe nevojat e tregut të punës. **[FE17]** Për shembull, Fakulteti i Ekonomisë ka hapur tre programe “Master Profesional”, në përputhje me prirjet dhe nevojat e tregut të punës. **[FE17]** Universiteti është në procesin e hapjes së një programi master në drejtësi në bashkëpunim me një institucion italian. **[FE21]** Fakte të tilla tregojnë se USH-ja përmbush kriterin e përputhshmërisë së programeve të studimit me prirjet vendore, kombëtare dhe ndërkombëtare. **[Kapitulli I Standardi I.4]**
- 3.5 Ngarkesa mësimore e pedagogëve caktohet në përputhje me kriteret e parashtruara nga aktet nënligjore. **[3.16]** Ngarkesa mësimore shtesë e pedagogëve financohet nga burimet e vetë institucionit. **[3.15]** Programet e studimit organizohen në mënyrë të tillë që të garantojnë bashkërendimin e ngarkesës mësimore, kërkimit shkencor dhe punës administrative. **[FE22; FE30]** **[Kapitulli I Standardi I.5]**
- 3.6 Në RVV, USH-ja deklaron se studentët janë të informuar për programet e tyre të studimit. Kjo gjë u pohua edhe nga studentët që u takuan me Grupin e Vlerësimit të Jashtëm. **[M5a]** Për studentët e transferuar jepet informacion i hollësishëm rreth kurrikulës, kërkimit dhe standardeve. **[RVV fq.26; 3.2]** Objektivat lidhur me përfshirjen e njohurive dhe aftësive që mund të përvetësojnë studentët nga programet përkatëse të studimit janë të përcaktuara

qartë të këto të fundit. **[RVV fq26]** Kriteret e pranimit të studentëve vendosen nga USH-ja, duke respektuar bazën përkatëse ligjore, dhe publikohen në faqen e internetit. **[RVV fq.26; M5a; 5b] [Kapitulli I Standardi I.6]**

- 3.7 Programet e ciklit të parë të studimeve i pajisin studentët me njohuritë bazë, si dhe me metodat dhe parimet e përgjithshme shkencore. **[RVV fq.26]** Për shembull, guidat e programeve **[3.4.1.8; 3.4.1.9]** ofrojnë lëndë hyrëse në vitin e parë që përqendrohen kryesisht në përvetësimin e aftësive teorike dhe themelore, duke vazhduar me lëndë më të zbatuara në vitin e tretë. Programet e studimit janë të hartuara në mënyrë të tillë që t'i lejojnë studentëve t'i transferojnë studimet e tyre në programe të ngjashme. **[3.6] [Kapitulli I Standardi I.7]**
- 3.8 Shqyrtimi i guidave të programeve konfirmon pohimin e universitetit se programet e ciklit të parë janë të formuara në mënyrë të tillë që të zhvillojnë aftësimin bazë në lëndët kryesore, duke u mbështetur rrjedhimisht në njohuritë e fituara në shkollën e mesme. **[3.4.1.8; 3.4.1.9]** Studentët marrin informacione të plota në momentin e regjistrimit. **[M12]** Universiteti i pajis studentët me manuale të hollësishme për programet e tyre përkatëse të studimit. **[2.7]** USH-ja vendos disa kriteret, si psh. titujt akademik dhe diplomat gjatë përzgjedhjes së stafit të ri akademik. **[M10]** USH-ja nuk e përmbush në mënyrë të qëndrueshme standardin e realizimit të ngarkesës mësimore në masën 70 për qind nga stafi akademik me kohë të plotë në studimet e ciklit të parë dhe të dytë. **[RVV fq.27, fq.52]** Universiteti është i ndërgjegjshëm për këtë gjë, dhe po merr masa për të garantuar realizimin e përqindjes së kërkuar në të gjitha programet e ciklit të parë. Veprimet e universitetit në këtë drejtim përfshijnë edhe rekrutimin e alumni, si dhe rekrutimin e stafit të ri dhe me përvojë. **[M1]** Grupi i Vlerësimit të Jashtëm **pohon** veprimet që po ndërmerren për garantimin e përmbushjes së 70 përqindëshit të ngarkesës mësimore në studimet e ciklit të parë nga ana e stafit me kohë të plotë. **[Kapitulli I Standardi I.8]**
- 3.9 Programet e studimit të ciklit të dytë të USH-së në "Master i Shkencave", janë hartuar për të mbështetur politikatat dhe strategjitë e kërkimit në përputhje me institucionin. **[1.2; 1.18]** Stafi akademik angazhohet në kërkime, përmes pjesëmarrjes së vazhdueshme në konferenca dhe projekte kombëtare dhe ndërkombëtare, botimit të artikujve shkencorë, **[1.27]** dhe organizimit të konferencave ndërkombëtare. **[3.17]** Krahas kësaj, në mesin e aplikimeve për vendet e lira të punës, përparësi për rekrutimin e stafit të ri iu jepet aplikantëve më të aftë. **[M1]** Në të njëjtën kohë, stafi akademik mbështet hartimin dhe vënien në praktikë të programeve të studimit. **[RVV fq.27]** Praktika profesionale brenda universitetit mundësohet nëpërmjet marrëveshjeve me institucionet vendore publike, si dhe me anë të bashkëpunimit me sektorin privat. **[1.26; 5.16]** Për mbikëqyrjen e temës së diplomës, universiteti bashkëpunon me sektorin privat/kompanitë shtetërore. **[FE23]** Zyra e Këshillimit të Karrierës është përgjegjëse për marrëdhëniet me alumni. Për mbledhjen e të dhënave të alumni është vënë në dispozicion një formular aplikimi online. **[FE34]** Universiteti nuk e përmbush në mënyrë të vazhdueshme kushtin e realizimit e të paktën 70 përqindëshit të ngarkesës mësimore të ciklit të dytë nga stafi akademik me kohë të plotë. Siç u theksua edhe më sipër lidhur me programet e ciklit të parë, universiteti është i vetëdijshëm për nivelin e stafit dhe po merr masa për përmbushjen e përqindjes së kërkuar nga të gjitha programet. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm **pohon** masat që po merren në lidhje me studimet e ciklit të dytë. **[RVV fq.28, p.52] [Kapitulli I Standardi I.9]**
- 3.10 Të tre ciklet e studimit të ofruara në USH janë në përputhje me Procesin e Bolonjës. Suplementi i diplomës përmban të gjitha informacionet e hollësishme në gjuhën angleze dhe shqipe. **[3.18]** Megjithëse studentët informohen rreth mundësive të studimit jashtë vendit, **[3.19]** ky informacion është i kufizuar, pasi gjatë periudhës 2014-2017 janë bërë vetëm pesë njoftime gjithsej. Gjatë ciklit të parë të studimeve, studentët kanë mundësi të përvetësojnë dy gjuhë të huaja, ndërsa gjatë pjesës së mbetur të programeve të studimit, ata janë të detyruar të vërtetojnë njohuritë e tyre në njërin prej tyre (si një kriter pranimi). **[3.8]** Përpos kësaj, në gjuhën angleze ofrohen disa programe, si p.sh. 11 kurse të Fakultetit të Ekonomisë, nëntë kurse të Fakultetit të Shkencave të Edukimit, si dhe të gjitha modulet e Fakultetit të Gjuhëve të Huaja. **[3.21]** Universiteti është pjesë e programeve TEMPUS, Erasmus+ dhe ka lidhur 39 marrëveshje bashkëpunimi me universitete të huaja, të cilat parashikojnë edhe mobilitet. **[1.22; 1.23, 1.25; M4]** Nga viti 2015 e deri më sot, në projekte mobiliteti kanë marrë pjesë rreth 180 anëtarë të stafit akademik dhe studentë. **[FE15]** Të gjitha së bashku, këto masa

lehtësojnë mobilitetin e studentëve shqiptarë në Evropë dhe më gjerë. **[Kapitulli I Standardi I.10]**

- 3.11 USH-ja organizon vizita në terren dhe **[3.22]** departamentet nxisin pjesëmarrjen e studentëve në veprimtari ekstrakurrikulare, **[3.23]** si p.sh në veprimtari sociale, kulturore dhe sportive. **[3.25]** Studentët e fakulteteve të ndryshme pohuan se studentët konsultohen për kurrikulat, dhe për më tepër, mund të propozojnë ndryshime për diskutim me qëllim përshtatjen sa më të mirë të kurseve me nevojat e tregut. **[M3]** Përpos këtyre, USH-ja ka hartuar udhëzues për përgatitjen e disertacionit të studentëve. **[3.24; 3.24.1] [Kapitulli I Standardi I.11]**
- 3.12 Programet e studimit ofrojnë module të veçanta të një natyre profesionale me njohuri që lidhen me fushat sociale dhe ekonomike, si dhe me praktikat profesionale. **[RVV fq.30-31; 3.4; 3.4.1.1- 3.4.1.12]** Universiteti ka dy laboratorë, që mbështesin proceset mësimdhënies përmes praktikës gjuhësore dhe teknologjike. **[RVV fq.31; 2.15]** Krahas kësaj, marrëveshjet dypalëshe me institucionet vendore lehtësojnë realizimin e plotë të stazheve të studentëve. **[1.26]** Bashkëpunimi i ngushtë me partnerët e jashtëm dhe me alumni ofron mbështetje të fortë për këto stazhe. **[M7a;M7b] [Kapitulli I Standardi I.12]**

Gjetjet

Praktika e mirë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë karakteristikë të praktikës së mirë.

Dobësitë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë dobësi.

Rekomandimet

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk dha asnjë rekomandime.

Pohimi i veprimeve të ndërmarra

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm pohoi veprimet e ndërmarra si më poshtë:

- masat që po merren për garantimin e realizimit të 70 përqindëshit të ngarkesës mësimore në studimet e ciklit të parë dhe të dytë nga ana e stafit me kohë të plotë (pika 3.8 dhe 3.9 **Kapitulli I Standardi I.8; Kapitulli I Standardi I.9**).

Gjykimi

Standardet për Kurrikulën janë përmbushur kryesisht.

Fusha e Vlerësimit 4: Mësimdhënia, Mësimnxënia, Vlerësimi dhe Kërkimi

- 4.1 Universiteti i organizon programet e studimit duke marrë parasysh nevojat e disiplinës, për shembull, përfshirjen e formimit profesional (stazhet) dhe vizitat në terren, ku është e nevojshme. **[RVV]**Universiteti ofroi shembuj që tregonin organizimin e programeve të studimit, duke përfshirë edhe shpërndarjen e stafit, të cilat vërtetonin planifikimin e kujdesshëm që sillte ekuilibrin e lëndëve të ndara sipas semestrave dhe viteve akademike. **[4.3]** Miratimi i planeve të studimit dhe ngarkesës individuale mësimore të stafit **[3.16]** bëhet fillimisht në nivel departamenti, për të kaluar më pas në nivel fakulteti te Dekani, dhe së fundi nga Senati.**[3.9]** Përgjithësisht studentët janë të kënaqur me metodat e mësimdhënies.**[Anketimi i studentëve]** dhe me ofrimin e literaturës mbështetëse.**[M5]** Universiteti ofroi edhe shembuj të manualëve të studentëve për ciklin e parë, të dytë dhe të tretë, **[AE41]** të cilat garantojnë një pikënisje të dobishme dhe ofrojnë kontekstin e duhur në mënyrë që studentët të kuptojnë natyrën e programeve të tyre.**[M6]** **[Kapitulli I Standardi II.1]**
- 4.2 Rregullat dhe kriteret e provimeve gjenden në faqen publike të internetit të universitetit,**[RVV]** dhe studentët raportuan që përgjithësisht ata ishin të kënaqur me sistemin e vlerësimit, rregullat, kriteret dhe proceset. **[Anketimi i studentëve; M5; M6]**Pavarësisht kësaj, më shumë se gjysma e studentëve të anketuar për këtë vlerësim, raportuan se ndonjëherë, studentët kopjonin gjatë provimeve. Perceptimet rreth proceseve të trajtimit të rasteve ku dyshohej se ishte kopjuar, ishin të ndryshme. Stafi me përvojë, me të cilin u takua Grupi i Vlerësimit të Jashtëm, pohoi se kopjimet ishin të rralla. **[M4]**Për më tepër, edhe në ato raste kur kopjohej, ndiqeshin procedurat vendore të universitetit mbështetur në zakone dhe praktika.**[M4; M11]** Një pjesë e stafit deklaroi që universiteti nuk kishte ndonjë udhëzim apo politikë që mund të ndiqej në raste të tilla. **[M10]**Megjithatë, pjesa tjetër **[M11;M12]** ishte e vetëdijshme se Kodi i Etikës **[1.9]** e konsideron kopjimin në provime si shkelje, dhe përcaktonte masat ndëshkuese që mund të merren për to, lidhur me përcaktimet e qarta në rregullore për të tre ciklet e studimit. **[3.6.1; 3.6.2; 3.6.3]**
- 4.3 RVV-ja pohoi se kriteret dhe procedurat e diplomimit afishohen në këndet e njoftimit të fakultetit dhe se kriteret i përmbahen kushteve të universitetit dhe mund të ndryshohen sipas rastit. Ndonëse universiteti nuk dha asnjë provë për ta mbështetur këtë pretendim, studentët konfirmuan që ata ishin në dijeni të kriterëve dhe procedurave përkatëse të diplomimit, dhe krahas kësaj, i kishin marrë diplomat zyrtare dhe suplementet e tyre. **[M5; M6]**
- 4.4 Gjatë korrigjimit të provimeve, respektohet fshehtësia e të dhënave personale **[AE25]** dhe ankimmimet, që shpesh njihen si ankesa, ndaj rezultateve të provimit shqyrtohen nga një komision i krijuar enkas. Në lidhje me këtë, u dha edhe një shembull.**[4.5]**Studentët ishin të informuar rreth këtij procesi. **[M6]****[Kapitulli I Standardi II.2]**
- 4.5 Për vlerësimin dhe përmirësimin e programeve, anketimet e studentëve dhe personelit administrohen nga NjSBC-ja, që është pjesë e Drejtorisë së Kurrikulave, Kërkimit Shkencor dhe Standardeve. Studentët i plotësojnë pyetësorët dy herë në vit,**[RVV; M12]** por deri tani është përdorur vetëm një mostër studentësh, në mënyrë që të mos rriten kostot. **[M4]** Megjithatë, me kalimin te pyetësorët online, universiteti planifikon t'i përfshijë të gjithë studentët. **[M4; M5]** Pyetësorët lidhen me mendimet e studentëve për programet e tyre të studimit dhe për stafin mësimdhënës. **[M5]** Megjithëse Grupi i Vlerësimit të Jashtëm zbuloi se kjo zyrë i mbledh të dhënat përmes ngritjes së fokus grupeve dhe grupeve të vlerësimit të programeve me studentë **[M2]**, ai nuk arriti t'i verifikonte këto veprimtari, pasi studentët me të cilët u takua nuk kishin informacion për grupe të tilla. **[M5; M6]** Departamentet i analizojnë të dhënat **[FE19; FE28]** për të krijuar raporte vjetore **[M3]**, të cilat përfshihen më pas në raportet e fakultetit **[4.7; 4.8]** për veprimtarinë e mësimdhënies dhe kërkimit, disa prej të cilave hartohen sipas vitit kalendarik, ndërsa disa të tjera sipas atij akademik. Raportet kalojnë te Drejtorja e Kurrikulës, Kërkimit Shkencor dhe Standardeve, përpara se të përpilohen në një raport të vetëm mbarë universitar nga Rektorati dhe të miratohen nga Senati. **[M3]**

Universiteti dhe studentët dhanë shembuj të rasteve ku ndryshimet që i janë bërë kurrikulës kanë ardhur si pasojë e sugjerimeve të studentëve dhe stafit. **[M2; M6]**

- 4.6 Universiteti përpiqet të monitorojë punësimin e të diplomuarve për vitin pasardhës, por ky proces është ende në hapat e tij të parë. **[4.9; AE24]** Komentet e tjera lidhur me këtë pikë mund të gjenden në pikat 1.17 dhe 5.13 të këtij raporti. **[Kapitulli I Standardi II.3]**
- 4.7 Në vijim të analizës së feedback-ut të marrë nga pyetësorët e studentëve, Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë u kërkoi departamenteve të përgatisnin një raport për efikasitetin e pedagogëve të tyre. **[AE29]** Kjo qasje retrospektive shërben si mjet kryesor për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies. **[M12]** Universiteti pohoi se njëri prej prioriteteve ishte përmirësimi i cilësisë së mësimdhënies **[M2]** dhe për ta mbështetur këtë, kishte përgatitur një Strategji të re për Mësimdhënien më mars të vitit 2017, **[4.11]** me objektiva të qarta për të përmirësuar trajtimin e dobësive specifike, por pa përcaktuar qëllimet ose treguesit e performancës për sinjalizimin e arritjes së progresit të dëshiruar. Gjithashtu, si pjesë e Treguesve Kyç të Performancës të Strategjisë Sektoriale janë trajtuar shumë çështje që lidhen me përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies, **[AE14]** por pavarësisht faktit se këta tregues janë të rinj (prill 2017) dhe ambiciozë, nuk kanë objektiva të përgjithshëm që tregojnë se kur duhet të arrihen.
- 4.8 Grupi i Vlerësimit të Jashtëm zbuloi se cilësia e mësimdhënies garantohet përmes kontroleve sporadike të stafit nga Përgjegjësi i Departamentit, i cili mban një dosje për çdo anëtar të stafit. **[M2]** Megjithatë, akademikët e nivelit të lartë, që janë përgjegjës për vlerësimin e mësimdhënies, e matin performancën duke u mbështetur përgjithësisht në përvojën e tyre si akademikë. Kjo gjë kontribuon në dobësinë e identifikuar më poshtë në pikën 4.10.
- 4.9 RVV-ja deklaroi se performanca e mësimdhënies së pedagogëve i nënshtrohej vlerësimit, por kjo gjë nuk mbështet nga faktet e dhëna. Pasi pyeti stafin, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm mësoi që pedagogëve të rinj u ofrohej mbështetje e përgjithshme dhe jo specifike, duke përfshirë edhe mentorim jozyrtar, **[M3]** por asnjë mbështetje e synuar. Kufizimet e mbështetjes që ofrohet për stafin e ri kontribuojnë në dobësinë e identifikuar më poshtë në pikën 4.10. **[M2]**
- 4.10 RVV-ja theksonte, dhe Grupi i Vlerësimit të Jashtëm zbuloi **[M2; M4; M11]** se stafi trajnohej në mësimdhënie përmes Qendrës së Ekselencës. Ndonëse Qendra ka qëllime dhe plane të shkëlqyera për zhvillimin e stafit **[RVV]** dhe organizoi një konferencë në vitin 2015 për “Metodat Bashkëkohore të Mësimdhënies”, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk arriti ta vërtetonte rolin e vazhdueshëm të Qendrës për përmirësimin e mësimdhënies. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm zbuloi gjithashtu se trajnimi nuk ofrohej sistematikisht për stafin e ri apo atë ekzistues, ose ofrohej në mënyrë oportuniste, dhe se nuk kishte asnjë nxitje specifike për eksperimentimin në mësimdhënie. **[M3; M4; M11; M12; M13]** Mungesa e një qasjeje efikase në nivel universiteti për nxitjen e përmirësimin të vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies për stafin e ri apo atë ekzistues është identifikuar si **dobësi**. **Rekomandohet** që universiteti të vërë në punë një sistem efikas dhe të ndërmarrë procedura shoqëruese për zhvillimin e të gjithë stafit mësimdhënës në mësimdhënie, mësimnxënie dhe vlerësim, duke marrë parasysh praktikën më të mirë aktuale. **[Kapitulli I Standardi II.4]**
- 4.11 Ndonëse departamentet janë njësia bazë e mësimdhënies dhe kërkimit, dhe kërkimi koordinohet dhe prioritetizohet në po të njëjtin nivel, edhe institutet e kërkimit dhe zhvillimit menaxhojnë dhe nxisin kërkimin. **[SER; M13]** Anëtarët e personeli kanë lirinë të ndjekin interesat personale të kërkimit, me kusht që të ndjekin orientimet e përgjithshme nga departamenti. **[M13]** Ndonëse financimi për kërkimin është i kufizuar, **[M4]** Grupi i Vlerësimit të Jashtëm pa dokumentet që vërtetonin alokimin e shumave të vogla **[4.18; M13]** për departamentet. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm u informua nga personeli që propozimet në departament paraqiteshin nga individë, dhe nëse ishin të suksesshme, duhet të raportonin sërish për ecurinë e kërkimit. **[M4]** Megjithatë, anëtarët e Bordit të Administrimit dhe stafit mësimdhënës u shprehën se nuk kishte asnjë financim për departamentet dhe universitetet. **[M10]** Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk arriti të krijonte një ide të qartë rreth marrëveshjeve të financimit.

- 4.12 Aktualisht ekzistojnë dy institute kërkimi, të cilat pasqyrojnë historinë dhe vendndodhjen e universitetit: Instituti i Studimeve Albanologjike dhe Instituti i Studimeve të Ujërave. **[M3]** Këto institute lehtësojnë bashkëpunimin e brendshëm, duke bashkuar stafin e departamenteve të ndryshme. Institutet e kërkimit mbështeten si financiarisht, **[4.18]** ashtu edhe përmes ofrimit të godinave, zyrave dhe infrastrukturave të teknologjisë së informacionit. **[M13]** Drejtoria e Kërkimit Shkencor mbikëqyr veprimtarinë kërkimore, duke përfshirë edhe monitorimin e ecurisë së projekteve të financuara nga universiteti. **[M1; RVV]** Në përpjekje për ta kodifikuar këtë mbikëqyrje, universiteti ka miratuar së fundmi në muajin shkurt të vitit 2017 Strategjinë e Kërkimit dhe Inovacionit, **[4.21]** i cili ka elementë dhe ambicie ndërkombëtare, si dhe plane veprimi për trajtimin e dobësive të identifikuar në kërkim. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm zbuloi se po planifikohej shtrirja e kërkimit. Në përputhje me trashëgiminë e tij në formimin e mësuesve, universiteti synon që, në të ardhmen, të hapë veprimtaritë kërkimore në arsimin shqiptar **[M1; M13]** duke përfshirë edhe një program doktorature. **[M1] [Kapitulli II Standardi I.2]**
- 4.13 Universiteti ndjek një politikë për ndërkombëtarizimin e kërkimit përmes marrëveshjeve me organet jashtë vendit **[1.22; 3.17; 4.19; M3]**, të cilat kanë sjellë rezultate me përfitime të dukshme, si p.sh shkëmbimin e anëtarëve të stafit dhe studentëve, përgatitjen e përbashkët e materialeve dhe programeve të mësimdhënies, ofrimin e harduerëve dhe organizimin e konferencave. **[AE31; M13]** Çdo vit, universiteti organizon disa kërkime dhe konferenca që lidhen me kërkimin, të cilat nuk zhvillohen të gjitha në Shkodër, **[3.17]** si dhe nxit stafin të t'i paraqesë organizatave të jashtme oferta për bashkëpunim në fushën e kërkimit, si p.sh. Komisionit Evropian. **[M4;13]** Shumë anëtarë personeli **[AE15; RVV fq.40 #4]** kanë përfituar nga bashkëpunimi jashtë vendit përmes programeve si Tempus dhe Erasmus+. **[M3; M4]** Debatimi shkencor nxitet në nivelin e duhur.
- 4.14 Grupi i Vlerësimit të Jashtëm zbuloi që pjesëmarrja gjithnjë në rritje nëpër konferenca kërkimi ishte një prioritet për universitetin, **[M2]** dhe ndonëse pjesëmarrja e personelit në konferenca ndërkombëtare **[1.27; AE19]** nuk është shumë e lartë, financimi evidentohet në shumë pak raste. **[M13]** Në të ardhmen, një pjesë specifike e buxhetit do t'i alokohet pjesëmarrjes së personelit në konferenca, sipas kriterëve të caktuar. **[M10; M12; M13]** Personeli i nivelit të lartë pohon se infrastruktura e kërkimit mund të përmirësohet dhe për këtë do të caktohet një pjesë e posaçme e buxhetit, përkundërt ofertave që mund të paraqesin departamentet. Siç u theksua edhe më sipër, personeli i ofrohet mundësia e caktimit të prioriteteve të tij të kërkimit brenda diapazonit të gjerë të parametrave të caktuar nga departamenti. **[M10] [Kapitulli II Standardet I.3 dhe I.4]**
- 4.15 Personelit në përgjithësi është i mirëkualifikuar në kërkim **[4.15]**, dhe përmes kriterëve të vendosura nga Senati, **[M10]** theksohet rekrutimi i personelit aktiv në fushën e kërkimit, **[RVV]** veçanërisht i atyre që trajnohen jashtë vendit **[M1; M3]** si dhe mbështetja e tyre për përfundimin e studimeve të doktoraturës jashtë Shqipërisë. **[M3; M6] [Kapitulli II Standardi I.5]**
- 4.16 Studentët e ciklit të dytë dhe të tretë nxiten të marrin pjesë në kërkim përmes programeve të studimit dhe të ndjekin konferenca në Shqipëri dhe më gjerë. **[RVV; M6]** Ka njëfarë mobiliteti ndërkombëtar për studentët, **[M6]** por niveli i tij është i ulët. **[RVV]**
- 4.17 Në RVV, ofrimi i veprimtarive kërkimore shkencore nga universiteti në vijimësi, konsiderohej si dobësi dhe në këtë drejtim, nuk u ofruan fakte bindëse. Universiteti raportoi përputhshmëri, por në pjesën më të madhe të rasteve nuk kishte fakte, madje edhe ato fakte që u ofruan nuk i mbështesnin këto pretendime, si në rastin e prioritizimit të doktoraturave të reja dhe informimit rreth anëtarëve të personelit që shkojnë jashtë vendit për formim. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm kërkoi informacion lidhur me këto dy çështje, por përgjigja që mori ishte se universiteti nuk i kishte këto të dhëna. Shumë anëtarë të personelit janë anëtarësuar në këshilla botues **[AE19]** dhe pjesa më e madhe e artikujve të universitetit botohen në periodikun e tij. **[4.25]** Anëtarët e personelit me të cilët u takua Grupi i Vlerësimit të Jashtëm **[M12]** nuk i kuptonin botimet ndërkombëtare dhe universiteti do të donte të identifikonte mënyrat për të mbështetur botimet e periodikëve shkencorë ndërkombëtarë, duke rritur kështu ekspozimin e universitetit. **[Kapitulli II Standardi I.7]**

4.18 Institutet e kërkimit vlerësohen përmes raporteve vjetore që i dorëzojnë Senatit. **[M3]** Në nivel departamenti, të dhënat rreth veprimtarive kërkimore mbledhen çdo vit **[RVV; M13]** përmes mbledhjeve individuale me personelin **[M1]** dhe përmbledhen në raportet dhe planet retrospektive të vitit të ardhshëm. **[AE30; M1]** Raportet përgatiten në nivel universiteti dhe vetëm një raport i përgjithshëm **[1.27; M3]** miratohet nga Senati. **[M1]** Raporti i përgjithshëm paraqet analizën e veprimtarive, si dhe vë në dukje se metodat e ndjekura nuk lejojnë vlerësimin e performancës së fakulteteve dhe departamenteve, veçanërisht për sa i përket qëllimeve dhe progresit drejt tyre. **[1.27, p2]**

Gjetjet

Praktika e mirë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë karakteristikë të praktikës së mirë.

Dobësitë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi dobësinë e mëposhtme:

- mungesa e një qasjeje efikase që mbarë universitare, për nxitjen përmirësimit e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies, si për anëtarët e rinj të personelit, ashtu edhe për ata me përvojë (pikat 4.10; **Kapitulli I, Standardi II.4**).

Rekomandimet

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm dha rekomandimin e mëposhtëm:

- vënia në punë e një sistemi efikas, si dhe zbatimi i procedurave përkatëse, për zhvillimin e stafit akademik në mësimdhënie, mësimnxënie dhe vlerësim, duke marrë parasysh praktikën më të mirë aktuale (pika 4.10; **Kapitulli II, Standardi II.4**).

Pohimi i veprimeve të ndërmarra

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk pohoi asnjë veprim të ndërmarrë.

Gjykimi

Standardet për Mësimdhënien, Mësimnxënien, Vlerësimin dhe Kërkimin janë përmbushur plotësisht.

Fusha e Vlerësimit 5: Studentët dhe Mbështetja e tyre

- 5.1 Universiteti ka miratuar Planin e Zhvillimit Strategjik dhe politika e pranimit pasqyron objektivat specifike të këtij plani. **[1.18]** Pranimi në universitet kryhet në përputhje me Ligjin Nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin në institucionet e Arsimit të Lartë në Shqipëri” dhe me kriteret e parashtruara në rregulloret e Statutit dhe të programeve të studimit për çdo cikël. Institucioni ka procedurë pranimit për ciklin e parë, të dytë dhe të tretë. **[RVV fq.43; 1.2 Neni 27 fq.31; 1.3; 3.6]** Përgjegjësia kryesore për zbatimin e politikave të pranimit i takon departamenteve dhe fakulteteve, si dhe Zyrës së re të Këshillimit të Karrierës. <http://www.unishk.edu.al/sq/content/kuotat-e-pranimit-cikli-i-par%C3%AB-i-dyt%C3%AB-dhe-i-tret%C3%AB-i-studimeve-viti-akademik-2017-2018>; <http://www.unishk.edu.al/sq/content/senati-vendimi-nr-16-dat%C3%AB-18012017-p%C3%AB-miratimin-e-kritereve-t%C3%AB-pranimit-t%C3%AB-kandidat%C3%ABv%C3%AB>; <http://www.unishk.edu.al/sq/search/node/pranimet> <http://www.unishk.edu.al/sq/content/vendimi-nr-329-dat%C3%AB-25072016-p%C3%AB-miratimin-e-formula-ve-t%C3%AB-p%C3%ABrzgjedhjes-t%C3%AB-kandidat%C3%ABve-q%C3%AB>; **1.21** **[Kapitulli I Standardi III.1]**
- 5.2 Universiteti i ruan kontaktet me institucionet e arsimit të mesëm përmes bashkëpunimeve me Drejtoritë Arsimore Rajonale, dhe çdo vit organizon ditët e hapura për gjimnazistët. **[RVV fq.43; M12; M14; 1.26; 3.3]** Departamentet dhe Zyra e Këshillimit të Karrierës janë përgjegjëse për informacionin rreth pranimit të studentëve të mundshëm dhe të ardhshëm. Departamentet caktojnë mentorë për çdo program studimi, që janë përgjegjës për dhënien e informacioneve rreth programit të studimit dhe planit akademik. Në çdo fakultet, organizohen mbledhje për studentët e vitit të parë të studimeve Bachelor, në mënyrë që të njihen me programet e studimit dhe ambientet e universitetit. Informacioni ofrohet përmes faqes së internetit të universitetit dhe medias sociale. Në Fakultetin e Drejtësisë është krijuar një zyrë e re për informimin e gjimnazistëve. Për t'i përmbushur nevojat e studentëve, studentët njoftohen për orarin e shërbimit të zyrës. Në të gjitha strukturat e universitetit, oraret mësimore afishohen në mënyrë që studentët të marrin informacion, certifikata dhe shërbime të tjera të nevojshme. **[RVV fq.43; M5; M12; 1.21; 1.1 Neni 37]** **[Kapitulli I Standardi III.1]**
- 5.3 USH-ja ndjek politika për të mirëpritjen e studentëve të huaj. Pranimi i studentëve të huaj bëhet sipas kritereve të caktuara nga qeveria. Studentët e huaj vijnë kryesisht nga rajoni i Ballkanit dhe gjuha e tyre e studimit është gjuha shqipe. Studentët e huaj jo vetëm që studiojnë, por ndërmarrin edhe punë kërkimore në USH edhe në kuadër të programeve CEEPUS (Programi i Shkëmbimit të Studimeve Universitare për Evropën Qendrore) dhe Erasmus. **[5.1; 5.2;** <http://www.unishk.edu.al/sq/content/kuotat-e-pranimit-cikli-i-par%C3%AB-i-dyt%C3%AB-dhe-i-tret%C3%AB-i-studimeve-viti-akademik-2017-2018> **]** **[Kapitulli I Standardi III.1]**
- 5.4 Numri i studentëve propozohet nga departamentet dhe miratohet nga Senati Akademik. Ndërkohë, universiteti po kryen një studim të kombinuar që ka të bëjë me alumni, për të parë se cilat programe studimi kanë ofruar më shumë vende pune dhe pëlqehen më shumë nga studentët. Ky studim do të përfundojë në fund të këtij viti dhe do të orientojë universitetin për financimin dhe punësimin e stafit të ri. Numri i studentëve të rinj të regjistruar ka pësuar luhatje gjatë tre viteve të fundit akademike. **[GID]** Për vitin akademik 2015-2016, raporti i përgjithshëm institucional pedagog/student ishte 1: 65. Megjithatë, faktet tregojnë se raportet janë të ndryshëm në varësi të departamentit. **[FE38]** Metodologjia e llogaritjes nuk është e njësuar në nivel universiteti. Raporti pedagog/student është shumë i lartë te disa prej departamenteve, ndërsa te disa të tjera është i ulët. Siç u diskutua më parë në pikat 3.8 dhe 3.9, institucioni është i ndërgjegjshëm për problemet që lidhen me nivelet e stafit dhe po merr masat për zgjidhjen e tyre. **[Kapitulli I Standardi III.1]**
- 5.5 Universiteti ka disa njësi administrative që garantojnë të drejtën e studentit për t'u informuar. Studentët informohen përmes dekanatit, sekretarisë mësimore dhe njërive të tjera mbështetëse, të cilët kanë publikuar oraret zyrtare, si dhe kanë ofruar informacione dhe

mbështetje për procesin e mësimdhënies. [RVV fq.44; M14] Komunikimi realizohet përmes faqes së internetit të universitetit, posterave në godina dhe me anë të emailit. Stafi akademik ka adresën e emailit të universitetit. Dosja e çdo studentit ruhet në departament, ku mbahen të dhënat e kontaktit të tyre. [5.4] Universiteti i ruan dosjet personale të çdo studenti. Sekretaria e studentëve është përgjegjëse për krijimin dhe administrimin e dosjeve të studentëve. Universiteti ruan adresat e vendbanimeve, adresat e emailit dhe numrat e telefonit të çdo studenti. [RVV fq.44; 1.1 Neni 38, pika 3; 5.6;

<http://www.unishk.edu.al/sq/content/student%C3%AB>] Universiteti ka një sistem për menaxhimin e studentëve, të quajtur ESSE3. Sistemi ka një profil studentit që shërben si burim i mirë informacioni për mësimdhënien, vlerësimin, oraret dhe kreditet. Studentëve u pëlqen mundësia e marrjes së notave përmes sistemit ESSE3. Në të gjendet edhe një listë e anëtarëve të personelit me adresat e tyre të emailit, në mënyrë që studentët të komunikojnë me profesorët e tyre. Megjithatë, siç u diskutua edhe në pikën 2.11, ESSE3 është një burim i kufizuar i të dhënave të studentëve, i cili përmban notat dhe oraret, por jo informacione rreth programit. [M5; AE3; M14][Kapitulli I Standardi III.1; Kapitulli I Standardi III.2]

- 5.6 Krahas departamenteve dhe fakulteteve që udhëzojnë dhe këshillojnë studentët për të gjitha ciklet e studimit, universiteti ka ngritur edhe Zyrën e Këshillimit të Karrierës për të këshilluar dhe udhëzuar studentët. Kjo zyrë u hap në dhjetor të vitit 2016, dhe filloi të funksiononte në shkurt të vitit 2017. [1.21] Universiteti përdor disa mjete komunikimi për të garantuar mirinformimin e studentëve, si dhe orientimin e tyre nga stafi akademik dhe joakademik me përvojë. Në ditën e tyre të parë, studentët marrin pjesë në një mbledhje me stafin akademik, gjatë të cilit prezantohen me burimet e informacionit rreth kurrikulës. Fakultetet kanë edhe këndet e njoftimit, ku afishohen informacionet. [M12] Informacionet kryesore rreth programeve të studimit, rregulloreve dhe jetës studentore ofrohen në manualin e studentëve, ndërsa libërthi për përgatitjen e diplomës dhe udhëzuesi i fakultetit hidhen në faqen e internetit të universitetit. [RVV fq.45; 3.6; 3.24] Stafi akademik shfaq dëshirën për të ngarkuar materialet e mësimdhënies në sistemin ESSE3, por për momentin në të mund të hidhet vetëm plani mësimor. [M12] Zyra e Kurrikulës dhe Sekretaria ofrojnë mbështetje dhe udhëzim për ata studentë që kanë dëshirë të ndryshojnë programin e tyre të studimit. Ekzistojnë disa procedura që i lejojnë studentët të ndryshojnë programet e studimit dhe që lehtësojnë këtë proces. Ndryshimet e programeve të studimit brenda universitetit kryhen sipas akteve nënligjore të miratuara nga MAS-i. [1.1 Neni 38, pika 3] [Kapitulli I Standardi III.3]
- 5.7 Universiteti i kushton vëmendje të veçantë studentëve me nevoja të veçanta, si dhe studentëve të komuniteteve romë dhe egjiptiane në programet e studimit të ciklit të parë, duke i ofruar mbështetje në përputhje me kuadrin kombëtar ligjor. Universiteti ofron mbështetje financiare, që përfshin përjashtimin e pjesshëm ose të plotë nga tarifa e shkollimit, për studentët që u përkasin grupeve të veçanta, sipas kushteve të parashtruara në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.903, datë 21.12.2016. [5.7; M5; M10; M14; FE35] Godinat e reja do të jenë të aksesueshme përmes rampave. [M10] Sipas studentëve, aksesimi për në godinë nuk përbën problem, megjithëse vënë në dukje mungesën e infrastrukturës së posaçme për studentët e verbër. [M5] Universiteti ka kërkuar kuota të veçanta për studentët romë, egjiptianë dhe ata me nevoja të veçanta, të cilat janë miratuar çdo vit nga Këshilli i Ministrave. [<http://www.unishk.edu.al/sq/content/kuotat-e-pranimet-cikli-i-par%C3%AB-i-dyt%C3%AB-dhe-i-tret%C3%AB-i-studimeve-viti-akademik-2016-2017>] Studentët nxiten të merren me aktivitete sportive dhe mbështeten nga universiteti në përputhje me rregulloret. [RVV fq.45; 5.8] Universiteti ka ofruar bursa për studentët me rezultate të shkëlqyera akademike. Më parë, studentët mbështeteshin për të ndjekur programet me kohë të pjesshme, por ofrimi i këtyre programeve është ndërprerë tashmë. [M5; 5.9] [Kapitulli I Standardi III.4]
- 5.8 Çdo departament i universitetit ka programe studimi (cikli i parë dhe i dytë) dhe kurrikula për çdo lëndë të ofruar në program. Çdo syllabus përmban literaturën e kërkuar, atë shtesë dhe atë të rekomanduar. Universiteti ofron tekstet më të mira në gjuhën shqipe dhe angleze për çdo modul. [3.2] Biblioteka është vlerësuar pozitivisht në anketimet e studentëve dhe personelit, dhe rezultojnë se është mjaft e pasur në tituj. [Anketimi i studentëve; M9; M14] Disa departamente kanë bibliotekat e tyre. [2.17] Biblioteka ka 400.000 libra, 85 për qind e të cilave ndodhen në katalogun elektronik dhe mund të aksesohen online. Universiteti po ndërmerr procesin e digjitalizimit të materialeve të vjetra për të ruajtur pasurinë kulturore.

Biblioteka ka një koleksion të veçantë të librave në shqip, si dhe zotëron 28 libra me vlerë unike. Larmia e librave dhe gazetave të aksesueshme për studentët, si në gjuhën shqipe, ashtu edhe në gjuhë të tjera, mbështet në mënyrë efikase të nxënies së studentëve dhe punën kërkimore. **[RVV fq.46; M14] [Kapitulli I Standardi III.5]**

- 5.9 Universiteti e pasuron bibliotekën në mënyrë periodike. Planifikimi i buxhetit përfshin burimet që i alokohen bibliotekës. Literatura e re blihet çdo vit sipas propozimeve të secilit departament. Pedagogët i dhurojnë bibliotekës kopje të librave që ata vetë botojnë. **[5.11; M14]** Orari i hapjes së bibliotekës afishohet në godinat e universitetit dhe në faqen e internetit të bibliotekës. Biblioteka është e hapur për lexim deri në orën 7 të pasdites çdo ditë të javës, ndërsa gjatë fundjavës, vetëm të shtunën deri në orën 1. Studentët mund të gjejnë online informacione të publikuara. **[5.12; 2.17; <http://bush.unishk.edu.al>]** Megjithatë universiteti ka bibliotekën qendrore, fakultetet kanë bibliotekat e tyre të përkatëse. Kapaciteti i bibliotekës qendrore për studim arrin deri në 300 studentë. Studentët kanë në dispozicion tre kompjuterë dhe një fotokopje. Në katin e dytë ata mund të punojnë së bashku. Biblioteka ofron internet. **[M14]** Dokumentet e universitetit menaxhohen nga zyra e arkivës, por secila njësi ka arkivën e saj për ruajtjen e dokumenteve. **[5.10] [Kapitulli I Standardi III.5]**
- 5.10 Departamentet ofrojnë shërbimin e mentorimit për studentët. Personeli ka orarin zyrtar të punës, dhe ndonëse ndajnë zyrat me të tjerë, ata gjejnë kohë për t'u takuar me studentët edhe në mënyrë individuale. **[M12]** Orët zyrtare të çdo pedagogu përcaktohen në fillim të vitit akademik dhe përfshihen në ngarkesën mësimore vjetore. **[3.16]** Çdo pedagog ka dy orë pune të lira gjatë javës. Staf i akademik ofron edhe konsultime të planifikuara për t'i ndihmuar studentët që kanë vështirësi me procesin e të nxënies. **[5.5]** Çdo student ka të drejtë të ketë një mbikëqyrës gjatë përgatitjes së temës së diplomës. Departamenti miraton listën e studentëve dhe emrat e mbikëqyrësve. Studentët ndihmohen dhe udhëzohen në gjetjen e literaturës nga pedagogët e çdo moduli. **[3.2]** Universiteti ofron mbështetje shpesh për studentët me aftësi të kufizuara, si p.sh. studentët me dëmtime në shikimi, duke ofruar një formë të veçantë vlerësimi (provim me gojë) për këta studentë. **[M10]** Gjithashtu, për t'i ofruar ndihmë studentëve që kanë probleme me disa rregulla, rregullore apo orare, është miratuar një plan i posaçëm. Studentët mund të ankohen ose ankohen te Dekani i Fakultetit. **[M14] [Kapitulli I Standardi III.6]**
- 5.11 Studentët përfaqësohen në Senatin Akademik, Këshillin e Fakultetit dhe Bordin e Administrimit. **[1.2 neni 47, pika 2/b; 1.14]** Përfaqësuesit e studentëve marrin pjesë në të gjitha mbledhjet dhe shprehin mendimet dhe propozimet e tyre rreth kurrikulës, programeve të studimit dhe rregulloreve. **[RVV fq.48; M5]** Pjesë e njësisë së vlerësimit të brendshëm në çdo fakultet është edhe një student nga çdo fakultet. Studentët janë anëtarë të grupeve të vlerësimit të brendshëm për programet e tre cikleve të studimit. Këndvështrimet dhe vlerësimet e studentëve merren në konsideratë për të përmirësuar programet e studimit. **[RVV fq.47, M3; M3; 1.14]** Studentët mund të vetëdrejtohen përmes Këshillit të zgjedhur Studentor, mandati i të cilit zgjat një vit. Këshilli Studentor është një strukturë e pavarur që nxit pjesëmarrjen e studentëve në vendimmarrje dhe ushtrimin e të drejtës për të shprehur shqetësimet dhe sugjerimet rreth jetës në universitet. **[1.2 neni 49]** Megjithatë, aktualisht puna e Këshillit është pezulluar, në pritje të zgjedhjeve të reja. **[M2; FE36]** Grupi i Vlerësimit të Jashtëm **pohon** masat që po merren për zgjedhjen e një Këshilli të ri Studentor, i cili do të zyrtarizojë dhe përmirësojë pjesëmarrjen e studentëve në jetën e institucionit. **[Kapitulli I Standardi III.7]**
- 5.12 Universiteti ofron një larmi të aktiviteteve ekstrakurrikulare për studentët. **[3.23; 3.25; 2.12; M5]** Universiteti ka Departamentin e Edukimit Fizik dhe Sporteve që mbështet studentët gjatë organizimit të veprimtarive sportive. **[RVV fq.49; 5.15]** Gjithashtu, universiteti mbështet studentët që janë pjesë e skuadrave kombëtare të sportit duke i ofruar atyre një plan individual mësimdhënies, mbështetur në rregulloren e MAS-it. **[5.8]** Departamenti i Infermierisë organizon orët e hapura për veprimtaritë ndërgjegjësuëse për mbrojtjen e shëndetit, si dhe organizon fushata për dhurimin e gjakut. Ndërkohë, në Departamentin e Psikologjisë ndodhet një qendër e vogël për studentët, që u ofron atyre seanca këshillimi në rast të ndonjë shqetësimi psikologjik. **[M12; M5; RVV fq.48; 5.16] [Kapitulli I Standardi III.8]**

5.13 Zyra e Këshillimit të Karrierës organizon workshop-e dhe panairë pune për të ofruar shërbime profesionale në përgatitjen e të diplomuarve për tregun e punës. [M6] Senati Akademik ka miratuar së fundmi, në muajin shkurt të vitit 2017, strategjinë e punësimit dhe planin e veprimit, që synon të rrisë punësimin e studentëve të diplomuar nga USH-ja në tregun vendor dhe rajonal të punës.[4.10] si dhe po kërkon vazhdimisht të bashkëpunojë me Drejtorinë Rajonale Arsimore, bizneset vendore, alumni dhe grupet e tjera të interesit, me qëllim mbështetjen e të diplomuarve për punësim.[RVV fq.48; 5.20] USH-ja ka ndjekur një politikë pozitive punësimi për punësimin e të diplomuarve të tij në ambientet e universitetit. Ai ka punësuar 324 studentë të diplomuar gjithsej, prej të cilëve 155 me kohë të plotë, dhe 169 me kohë të pjesshme. Stazhet e ofruara tek institucionet vendore dhe letrat mbështetëse të dhëna nga profesorët i kanë ndihmuar shumë studentët të gjejnë një vend pune. Janë ndërmarrë dhe më parë nisma për mbledhjen e të dhënave rreth punësimit të diplomuarve, por vetëm në një fakultet (Fakulteti i Ekonomisë që prej vitit 2013), pasi pesë fakultetet e tjera nuk kanë pasur asnjë të dhënë të disponueshme.[4.9; FE34] Para gjashtë muajsh, USH-ja filloi të mbledhte të dhëna rreth të diplomuarve në nivel institucional përmes Zyrës së Këshillimit të Karrierës.[M14; 5.18; 5.21] Grupi i Vlerësimit të Jashtëm **pohon** se Zyra e Këshillimit të Karrierës ka krijuar një bazë të dhënash alumni në universitet, dhe se po punon për ta plotësuar atë në mënyrë sistematike. [M7a; 5.21] [**Kapitulli I Standardi III.9**]

Gjetjet

Praktika e mirë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë karakteristikë të praktikave të mira.

Dobësitë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë dobësi.

Rekomandimet

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk dha asnjë rekomandim.

Pohimi i veprimeve të ndërmarra

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm pohoi veprimet e ndërmarra si më poshtë:

- masat që po merren për zgjedhjen e Këshillit të ri Studentor, i cili do të zyrtarizojë dhe përmirësojë pjesëmarrjen e studentëve në jetën e institucionit (pika 5.11; **Kapitulli I Standardi III.7**)
- krijimin e një baze të dhënash alumni nga Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe puna për ta plotësuar atë në mënyrë sistematike (pikat 5.13; **Kapitulli I Standard III.9**).

Gjykimi

Standardet për Studentët dhe Mbështetjen e tyre janë përmbushur kryesisht.

GRUPI I PARË I DOKUMENTEVE TË OFRUARA ME RVV-në: REFERUAR SI FAKTE.

- 1.1-Rregullore e brendshme e administratës
- 1.2-Statuti i USH-së
- 1.3- Vendim për ndryshim Statuti
- 1.4- Vendim për Rregulloren e Brendshme të Administratës
- 1.5- Vendim për Buxhetin e vitit 2016
- 1.6- Rregullore e Bordit të Administrimit
- 1.7- Vendim i Bordit të Administrimit
- 1.8- Vendim i Këshillit të Etikës
- 1.9- Kodi i Etikës i USh-së
- 1.10- Rregullore e Këshillit të Profesorëve
- 1.11- Vendim i Këshillit të Profesorëve
- 1.12- Vendim i Këshillit të Fakultetit
- 1.13- Vendime Senati
- 1.14- Vendim KIZ
- 1.15- Struktura organizative 2015
- 1.16- Vendim i Komisionit ad hoc
- 1.17- Lista e projekteve
- 1.18- Strategjia 2017-2021
- 1.19- Raporti Vjetor për vitin 2016
- 1.20- Vendim Senati (Stafi akademik me kohë të plotë KA)
- 1.21- Vendim për Zyrën e Karrierës dhe Këshillimit
- 1.22- Lista e bashkëpunimeve dhe marrëveshjeve USH-UN
- 1.23- Shembull Projekti Tempus
- 1.24- Shembull Studim i Tregut të Punës
- 1.25- Projekti Erasmus
- 1.26- Shembuj të bashkëpunimeve me institucionet USH
- 1.27- Raporte të punës kërkimore shkencore dhe mësimdhënies për vitin 2016
- 2.1- Struktura organizative
- 2.2- Ruajtja e vendit të punës 2009
- 2.3- Raporti i Senatit 09.11.2016
- 2.4.1- Vlerësim rrjeti FSHE
- 2.4.2- Marrëveshje me të brendshëm
- 2.4.3- Marrëveshje me të huaj
- 2.4.4- Marrëveshje me të jashtëm
- 2.4.5- Kriteret e punësimit
- 2.4.6- Kriteret ekonomike.jpg
- 2.5- Titujt dhe diplomat
- 2.6- Personat e famshëm, Francesco Altimari, Matteo Mandala
- 2.7- Ditët e hapura FSS (2), Manuali i studentëve-Fakulteti i Ekonomisë
- 2.8- Dokumenti 7 Mars Prokurimi
- 2.9.1- Giulio Masotti
- 2.9.2- Njohja e ekonomiksit
- 2.9.3- Roberta Majerhofer
- 2.9.4- Ted Oelfke
- 2.9.5- Augusta Brettoni
- 2.10- Florian Mandija, ICRAE, Ftesë B.Bushgjokaj
- 2.11- Lista e profesorëve të huaj në FGJH, dhe Fakultetin Ekonomik gjatë pesë viteve të fundit
- 2.12.1- Frekuentimi i bibliotekës
- 2.12.2- Projekti i riaktivizimit të Kampionatit të Debatit në vitin 2016
- 2.12.3- Certifikatë për Kampionatin e Debatit, 2015

- 2.13- Politikat e auditimit të brendshëm, raporti i monitorimit vjetor
- 2.14- Shprehje interesi, Infrastruktura TIK
- 2.15- Infrastruktura e USH-së, Infrastruktura (Tabela e sipërfaqes)
- 2.16- Miratim i kuotave për projektbuxhetin 2017-2019
- 2.17- Manuali i bibliotekës
- 2.18- Titujt Emeritus dhe të Nderit
- 2.19- Instituti i Studimeve të Ujërave, Laboratori Mikrobiologjik
- 3.1- Lista e programeve të studimit
- 3.2- Karakteristikat e programeve të studimit
- 3.3- Informacion për organizimin e "Ditëve të hapura"
- 3.4- Procedurat për hartimin dhe miratimin e programeve të studimit
- 3.5- Informacion për hapjen e programeve të reja të studimit
- 3.6- Rregulloret e studimit dhe Vendimi Nr.407, datë 06.10.2016
- 3.7- Vendim Nr.16, datë 01.18.2017
- 3.8- Vendimi Nr.409, datë 10.06.2016
- 3.9- Procedurat për të mbështetur dhe përmirësuar cilësinë e programeve të studimit
- 3.10- Vendim Senati Nr. 103, datë 18.03.2015
- 3.11- Workshop-i "Metodat bashkëkohore të mësimdhënies"
- 3.12- Certifikatë akreditimi
- 3.13- Shembuj të raporteve të vlerësimeve periodike të programeve të studimit
- 3.14- Marrëveshja me Universitetin e Napolit
- 3.15- Relacion i Mbledhjes së Senatit, datë 09.11.2016
- 3.16- Marrëveshje model
- 3.17- Veprimtari të kërkimit shkencor të kryer nga USH-ja
- 3.18- Modelet e suplementit
- 3.19- Informacion për mundësitë e studimit jashtë vendit
- 3.20- Kriteret dhe procedurat për transferimin e studentëve
- 3.21- Lista e kurseve të ofruara në gjuhë angleze
- 3.22- Organizimi i ekspeditave (udhëtime në terren)
- 3.23- Aktivitete studentore
- 3.24- Udhëzues për përgatitjen e një teme diplome
- 3.25- Pjesëmarrja e studentëve në aktivitete kulturore
- 4.1- Memorandum Marrëveshjeje me Kolegjin Sandhills (mundësi stazhi)
- 4.2- Certifikatë për përvojën e praktikës dhe trajnimin
- 4.3- Raport i praktikës-stazhit profesional vjetor
- 4.4- Raporti i pedagogut për ekspeditat e studentëve në terren
- 4.5- Procedura për ankimimin e notës nga ana e studentit
- 4.6- Shembuj të komisioneve të vlerësimit të studentëve
- 4.7- Model i një analize nga departamenti për veprimtarinë akademike dhe shkencore
- 4.8- Modelet e vlerësimit të performancës së pedagogëve
- 4.9- Shembuj të statistikave për praktikën e të diplomuarve
- 4.10- Strategjia e kërkimit të tregut të punës
- 4.11- Strategjia e mësimdhënies
- 4.12- Shembull kontrate e nënshkruar nga stafi akademik në rast mobiliteti
- 4.13- Deklaratë objektivash CEEPUS dhe EUREQA
- 4.14- Rregullore e Qendrës së Ekselencës
- 4.15- Statistikat për kualifikimet e stafit akademik
- 4.16- Vendim për krijimin e Institutit të Albanologjisë dhe Institutit të Studimit të Ujërave

- 4.17- Raport për veprimtarinë kërkimore të institucionit
- 4.18- Dokumente për financimin e kërkimit shkencor dhe veprimtarive të institucionit
- 4.19- Shembuj të Memorandumeve të Mirëkuptimit me universitete ndërkombëtare

- 4.20- Rregullore e institucionit të kërkimit
- 4.21- Strategjia e kërkimit dhe inovacionit

- 4.22- Marrëveshje shembull me institucione kombëtare të kërkimit
- 4.23- Fakte për mbajtjen e leksioneve në shkallë ndërkombëtare nga stafi akademik
- 4.24- Shembuj të leksioneve të hapura nga personalitete të shkencës
- 4.25- Shembuj të librave të botuar nga stafi akademik
- 4.26- Shembull i pjesëmarrjes në këshillat botues
- 4.27- Botim në gazetë i veprimtarisë kërkimore
- 4.28- Shembull i marrëveshjeve me institucionet ekonomike
- 5.1- Listë përmbledhëse e studentëve nga banka shqiptare
- 5.2- Listë përmbledhëse e studentëve të huaj
- 5.3- Studentë të huaj që kanë studiuar pranë USH-së
- 5.4- Strategjia e Komunikimit dhe Informacionit Publik
- 5.5- Përcaktimi i orëve të mbledhjeve për leksionet
- 5.6- Forma e mësimdhënies, sekretaria
- 5.7- Mbështetja financiare për studentët në nevojë
- 5.8- Plani individual për atletët më të mirë
- 5.9- Listë përmbledhëse e studentëve në sistemin e studimit me kohë të pjeshme
- 5.10- Udhëzim për procesin e arkivimit dhe korrespondencës në USH
- 5.11- Investimet që nevojiten për Bibliotekën e USH-së
- 5.12- Rregullore e Bibliotekës së USH-së
- 5.13- Gazeta “Nisma”
- 5.14- Kërkesë për lejimin e shpërndarjes së gazetës studentore
- 5.15- Diplomat dhe Certifikatat e dhëna në veprimtaritë sportive
- 5.16- Marrëveshje me Kryqin e Kuq
- 5.17- Ftesë për mbledhje Alumni
- 5.18- Raport për mbledhje Alumni
- 5.19- Raport projekti për U3M-AL
- 5.20- Ftesë për veprimtaritë e Fakultetit të Ekonomisë
- 5.21- Statistikat për ish-studentët që punojnë si pedagogë pranë USH-së

Paketa e dytë e provave të referuara si Prova Shtesë:

- | | |
|----|--|
| 1 | Këshilli i Fakultetit |
| 2 | Qëllimi dhe planet e Zyrës së Karrierës |
| 3 | Procesverbalet e Senatit dhe Bordit të Administrimit |
| 4 | Fakte që vërtetojnë se si universiteti përkrah debatin |
| 5 | Strategjia e ndërkombëtarizimit |
| 6 | Shënim për programet e nxitjes për stafin e ri |
| 7 | Buxheti aktual |
| 8 | Deklaratë e universitetit për buxhetin |
| 9 | Shembuj të ofertave të buxheteve të departamenteve |
| 10 | Raport i auditit të brendshëm/jashtëm |
| 11 | Sigurimi shëndetësor që i ofrohet stafit |
| 12 | Shënim për sigurimin e cilësisë |
| 13 | Shënim për komisionin ad hoc |
| 14 | Përmbledhje e treguesve kyç të performancës |
| 15 | Mobiliteti i stafit dhe studentëve |
| 16 | Integrimi i stafit të huaj |
| 17 | Analizë e tregut të punës nga USH-ja |
| 18 | Qendra e Ekselencës |
| 19 | Shembuj të anketimeve të kryera nga NjSBC |
| 20 | Strategjia e Zhvillimit |
| 21 | Informacion rreth programeve të përbashkëta |
| 22 | Ngarkesa mësimore |
| 23 | Dokumente që lidhen me bashkëpunimin për mbikëqyrjen e temës së diplomës |

24	Statistika rreth punësimit
25	Korrigjim dhe regjistrim i fshehtë i provimeve të të diplomuarve
26	Shënim për procesin e ankimimit ndaj rezultateve të provimeve
27	Procesverbale të mbledhjeve të fakultetit
28	Pyetësor i studentëve
29	Roli i SAQ-SADCRS
30	Vlerësim i punës kërkimore
31	Rezultatet e marrëveshjeve
32	Fakte që stafi që ka udhëtuar jashtë vendit
33	Informacione rreth burimeve njerëzore
34	Baza e të dhënave alumni
35	Bursa për studentët
36	Këshilli Studentor
37	<i>Shihni Dokumentet Shtesë 26</i>
38	Raporti numerik i stafit akademik me studentët
39	Bashkëpunimi me bashkinë
40	Shënim për programet e nxitjes për studentët
41	Manuali i studentëve: cikli i parë, i dytë dhe i tretë

Dokumentet e dorëzuara gjatë vizitës të referuara si Dokumente Shtesë:

1	Infrastruktura e USH-së
2	Shpallje e vendeve të lira në Buletin e Prokurimeve
3	Pamje të ekranit të sistemit ESSE 3
4	Shëmbull i përmirësimit të programeve të studimit
5	Rregullore e studimeve
6	Procedura e hapjes së një programi studimi
7	Projekt Statuti i ri i USH-së

Shënim- Të gjitha dokumentet shtesë janë dorëzuar në gjuhën shqipe. Ndonëse dokumentet e renditura në listat e Dokumenteve dhe Dokumenteve Shtesë i kanë emërtimet në anglisht, disa prej këtyre dokumenteve ose pjesë të përmbajtjeve të tyre, mund të jenë në gjuhën shqipe.

Mbledhjet

- M1 – Mbledhja 1
- M2 – Mbledhja 2 Grupi i Vetëvlerësimit
- M3 – Mbledhja 3 Senati Akademik
- M4 – Mbledhja 4
- M5 – Mbledhja 5 Studentët e ciklit të parë
- M6 – Mbledhja 6 Studentët e ciklit të dytë dhe të tretë
- M7 – Mbledhja 7 Takim me Alumni
- M9 – Mbledhja 9 Turi i universitetit
- M10 – Mbledhja 10 Mbledhje me Bordin e Administrimit dhe personelin e nivelit të lartë
- M11 – Mbledhja 11
- M12 – Mbledhja 12 Stafi akademik
- M13 – Mbledhja 13
- M14 – Mbledhja 14 me shërbimet mbështetëse